



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 27/2020 Regjistri (JR)
Datë 09.07.2020

Nr. 30 i vendimit
Datë 25.07.2022

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Natasha Mulaj	Relatore
Mimoza Tasi	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 25.07.2022, ditën e hënë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Gjovalin Përnoca, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

OBJEKT: Shqyrtimi i vendimit nr. 196, datë 13.09.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Gjovalin Përnoca.

BAZA LIGJORE: Nenet 6, 7, 8, 13, 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave e Lirive Themelore të Njeriut, [me Protokollet (1) e (12), të saj]; Nenet 18, 29, 30, 31, 33/1, 41, 42 dhe 179/b, paragrafët 1, 2 dhe 5 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Neni A pika 1, neni C pikat 3 e 5, neni D pika 4, si dhe neni F pikat 1, 2, 3 e 7 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Nenet 62, 63, 65 dhe 66 pika 1, germa “b” të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Nenet 46, 47, 48 dhe 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim dhe parashtrime, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 196, datë 13.09.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë në tërësi,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit Gjovalin Përnoca (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit për Krimeve të Rënda Tiranë. Për shkak të funksionit, bazuar në nenin 179/b, pika 3 të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, ai iu nënshtrua rivlerësimit *ex officio*.
2. Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), mbështetur në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, administroi raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Grupi i Punës në Këshillin e Lartë Gjyqësor (në vijim KLGj).
3. Komisioni, pasi kreu për subjektin e rivlerësimit një hetim të plotë administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit, vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, si dhe pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e administruara, arriti në konkluzionet e mëposhtme.
 - 3.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:
 - a) *Subjekti ka kryer deklarim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm të pasurive të tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, germave “a” dhe “b”, të nenit 33/5 dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.*
 - b) *Subjekti ka kryer fshehje pasurie, në kuptim të germës “c”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.*
 - c) *Subjekti ka kryer deklarim të rremë në kuptim të germës “ç”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.*
 - ç) *Subjekti nuk ka justifikuar me burime të ligjshme blerjen e pasurive të luajtshme apo të paluajtshme prej tij apo e personave të lidhur me të, dhënien e huave prej tij apo e personave të lidhur me të tek të tretët, aftësinë financiare të të tretëve për kthimin e huave, krijimin e likuiditeteve prej tij apo e personave të lidhur me të, si dhe mbulimin e shpenzimeve prej tij, apo e personave të lidhur me të për periudhën e rivlerësimit.*
 - d) *Subjekti nuk paraqiti prova, si dhe nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave dhe pasurive të tij, sipas pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.*

3.2. Për kriterin e kontrollit të figurës:

Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të ketë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, apo që të jetë i përfshirë ose i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe, si rrjedhojë, e gjen atë të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

3.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:

Nga vlerësimi tërësor i kriterit profesional ka konstatuar mangësi dhe problematika në aspektin procedural nga subjekti i rivlerësimit, por trupi gjykues vlerëson se ato nuk janë deri në atë masë që të plotësojnë qëllimin e nenit E të Aneksit të Kushtetutës apo pikës 4, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe, për rrjedhojë, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

4. Në përfundim, Komisioni, me vendimin nr. 196, datë 13.09.2019, ka vendosur: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Gjovalin Përnoca.*

II. Shkaqet e ankimit

5. Subjekti i rivlerësimit Gjovalin Përnoca ka ushtruar ankim ndaj vendimit nr. 196, datë 13.09.2019, të Komisionit, duke kërkuar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, ndryshimin e këtij vendimi dhe konfirmimin e tij në detyrë.

5.1. Shkaqet ankimore me natyrë procedurale të ngritura nga subjekti i rivlerësimit në ankim dhe parashtrime, në mënyrë të përmbledhur janë si më poshtë.

5.1.1. Komisioni ka cenuar rëndë të drejtën për një proces të rregullt ligjor, duke kryer shkelje të rënda procedurale dhe materiale, të cilat vijnë në kundërshtim të hapur me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë e ligjin nr. 84/2016.

5.1.2. Vendimi i Komisionit është rezultat i një procesi të paragjykuar, si dhe i mosbërjes së një analize të provave të paraqitura nga ana e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit, duke mos i dhënë fuqi provuese, bazuar në përmbajtjen dhe vërtetësinë e tyre, si dhe ka raste të “parashtrimit të shtrembëruar të fakteve në aktet e nxjerra” (në kundërshtim me nenin 16/7 të ligjit nr. 84/2016).

5.1.3. Procedura e hetimit administrativ ka filluar, ka vazhduar dhe është përfunduar nga të njëjtët anëtarë të trupit gjykues, të cilët kanë marrë pjesë dhe kanë dhënë vendimin përfundimtar, ky fakt përbën shkelje flagrante të parimit të paanësisë të trupit gjykues i garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 6, pika 1 e Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut, ligjit nr. 84/2016, si dhe Kodi i Procedurave Administrative.

5.1.4. Vendimi i Komisionit nuk është marrë nga një gjykatë e krijuar me ligj, sipas kërkesave të nenit 42 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 6 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut (në vijim “KEDNj”), duke qenë se kjo shkelje cenon zhvillimin e një “procesi të rregullt ligjor”, ky vendim, sipas tij, duhet të konstatohet si absolutisht i pavlefshëm nga Kolegji, në zbatim të germës “a” të nenit 108 të Kodit të Procedurave Administrative.

5.1.5. Komisioni ka shkelur disa parime bazë të KEDNj-së, si parimi i procesit të rregullt ligjor, parimi i barazisë para ligjit, parimi i barazisë së armëve juridike (duke mos u marrë provat e kërkuara nga subjekti, por vetëm ato të Komisionit), parimi i sigurisë juridike (duke kërkuar të dhëna të hollësishme për periudha të largëta kohore), si dhe duke mos marrë parasysh paragrafin 4 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se subjekti prezumohet fajtor për shkelje disiplinore nëse ka një pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme [...], parimi i proporcionalitetit (duke dhënë një masë jo proporcionale në raport me shkeljet e konstatuara), duke u bërë hetime të paplota, duke mbajtur qëndrime të ndryshme për situata të ngjashme.

5.1.6. Subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji, si e vetmja instancë gjyqësore, të drejtën për t'u dëgjuar në një seancë gjyqësore publike, sipas nenit 6/1 të KEDNj-së, ku kërkon të paraqesë dhe të merren në shqyrtim disa prova të reja, referuar nenit 17 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

5.2. *Shkaqet ankimore mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë, janë si më poshtë.*

5.2.1. *Për pasurinë “apartament banimi” dhe “dy garazhe”, blerë në bashkëpronësi me z. A. G., ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë*

Kontratën e porosisë për këtë pasuri nuk e ka deklaruar si “trajtim preferencial” në deklaratën e pasurisë të vitit 2005, por e ka pasqyruar si një kontratë të thjeshtë porosie, pasi ka pasur bindjen se po e blinte këtë pronë në koston reale, rreth dyfishin e saj dhe nuk po përfitonte asgjë nën kosto. Për subjektin e rivlerësimit, kjo kontratë ishte një veprim juridik i zakonshëm, pasi nuk ishte në kushtet e detyrimit për ta trajtuar si dhuratë.

Lidhur me pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, për të justifikuar investimet, kursimet dhe shpenzimet e kryera prej tyre në vitin 2005 konstatuar nga Komisioni në vendimin e ankimuar, subjekti i rivlerësimit ngre pretendimin se ky vit rezulton me bilanc pozitiv, nëse do të merret në konsideratë e ardhura e bashkëshortes për një punë jashtë orarit e kryer në entin botues, shoqëria “{***}” ShPK.

5.2.2. *Për pasurinë apartament 1+1, i blerë në {***}, për shumën 1.900.000 lekë, më datë 29.7.2005 dhe shitur më datë 9.2.2006, në shumën 3.400.000 lekë*

Dyshimi i Komisionit se kontrata ka pasur çmim jo real e fiktiv nuk është i bazuar, pasi: “Kontratat noteriale nuk mund të vërtetohen apo kundërshtohen me dëshmitarë, ato kanë fuqi të plotë provuese për kushtet e fiksuara në kontrata, prandaj, nuk mund të vihen në dyshim për sa u përket kushteve të përcaktuara në të”.

Konkluzioni i Komisionit, se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme financiare në vite, që të kenë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit në {***}, në shumën - 939.102 lekë, është i gabuar, pasi nuk ka marrë parasysh asnjë argument të analizës financiare depozituar nga vetë subjekti gjatë hetimit administrativ në Komision.

5.2.3. *Për pasurinë “ndërtesë dy kate + papafingo” dhe “truall” me sipërfaqe 175 m², ndodhur në rrugën “{***}”, nr. {***}, {***}, Tiranë, të blerë në vitin 1998*

Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka bërë ndërtim pa leje dhe nuk e ka deklaruar për sipërfaqet 11,8 m² në ndërtesën 3 (tre) -katëshe dhe 21.7 m² në papafingo, subjekti vlerëson se është plotësisht i pasaktë, pasi që nga blerja e asaj shtëpie, as subjekti dhe as babai, nuk kanë bërë asnjë metër katror ndërtim pa leje apo shtesë anësore të strukturës së murit, që nga kati përdhe deri në papafingo.

Subjekti pretendon se në deklaratimet periodike vjetore, por edhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, ka bërë një gabim formal duke e cilësuar pasaktësi dhe nxitim faktin se si burim për blerjen e banesës në rrugën “{***}”, Tiranë, në vitin 1998 së bashku me babain e tij, ku përveç të ardhurave nga shitja e shtëpisë në Shkodër, gabimisht ka deklaruar se një pjesë e të ardhurave ka qenë edhe nga shitja e shtëpisë në Mirditë (kur në fakt kjo shtëpi është shitur në vitin 1999).

Në lidhje me apartamentin e shitur në Shkodër, të ardhurat nga shitja e të cilit kanë shërbyer si një ndër burimet e krijimit të pasurisë shtëpi banimi në Tiranë, subjekti ngre pretendimin se, nëse Komisioni do të merrte në konsideratë në analizën financiare të kryer prej tij, të ardhurat nga paga e bashkëshortes gjatë viteve 1988 - 1993, si dhe dietat e kursyera nga shërbimi i

subjektit të rivlerësimit në ShBA, atëherë subjekti dhe personi i lidhur me të do të rezultonin me mjaftueshmëri burimesh financiare të ligjshme për blerjen e këtij apartamenti, në vitin 1996.

5.2.4. Për pasurinë depozitë në shumën 3.200.000 lekë e depozituar në bankë, më datë 20.09.2002, e cila i përket subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, si dhe depozita në shumën 35.000 USD e krijuar në bankë në vitin 2003 në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk e ka deklaruar këtë depozitë në deklaratat periodike të vitit 2003 dhe 2004, sepse nuk është depozitë e familjes së tij, por i përket mbesës së gruas M. V., e cila ia kishte lënë në ruajtje hallës, bashkëshortes së subjektit A. P..

Sipas subjektit, ai nuk ka pasur barrën e provës që të provojë origjinën e parave të depozituara në Bankën Amerikane, në vlerën 35.000 USD, në vitin 2002, pasi ato para ishin në ruajtje, dhe sipas deklaratave noteriale të vitit 2004 dhe 2019, të znj. M. V. dhe bashkëshortit të saj, konfirmohet fakti se ato shuma i përkasin znj. M. V. dhe bashkëshortit të saj, të fituar nga puna e tyre në Angli, gjatë viteve 1998 - 2002.

5.2.5. Për analizën e plotë të kryer për të gjithë periudhën e rivlerësimit 2003-2016

Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit në vendim për mungesën e burimeve të ligjshme financiare në shumën -2.271.477 lekë, pasi ka pasaktësi të dukshme, si: mos konsiderimi i të ardhurave të bashkëshortes në vitin 2005, shpenzimet jetike janë përlllogaritur sipas deklaratimeve të subjektit jo sipas INSTAT, por sipas deklaratimeve të subjektit në deklaratat periodike, Komisioni nuk ka konsideruar shpenzimet e udhëtimit si pjesë e shpenzimeve jetike si deklaruar prej subjektit, duhet korrigjuar vlerën e blerjes së apartamentit në bashkëpronësi në vitin 2011, konstaton t'i jenë përlllogaritur dy herë shpenzimet e legalizimit, diferenca negative e konstatuar në vitin 2014 është për shkak se Komisioni nuk ka marrë në konsideratë në mënyrën e duhur shpenzimet e shkollimit të djalit në Angli dhe ka kërkuar nga Komisioni të përsëritet akt-ekspertimi ekonomiko-financiar me një grup prej tri ekspertësh të licencuar, pasi vetëm kështu mund të konkludohet se cila është analiza e saktë.

III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

6. Trupi gjykues, kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen e provave¹ bashkëlidhur ankimit, e vlerësoi në raport me parashikimet ligjore që normojnë trajtimin e provës së re në gjykimin administrativ në shkallë të dytë, referuar nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar [në vijim “ligji nr. 49/2012”], i cili parashikon: “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohej prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”.
7. Subjekti i rivlerësimit, pas marrjes së njoftimit për gjykimin e çështjes në dhomë këshillimi, më datë 25.07.2022, paraqiti në Kolegj, më datë 19.07.2022, parashtrime me shkrim “Shtesë Ankimi”, duke konfirmuar se i qëndron të gjitha shkaqeve të ankimit të paraqitura në “Ankim”,

¹ Kërkesë e subjektit të rivlerësimit, datë 17.12.2019, drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorisë Vendore Tiranë, me dokumentacionin bashkëlidhur; Përgjigja e Kadastrës, Tiranë, datë-30.12.2019; Kërkesa e datës 27.04.2020, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Kadastrës; Kontrata e sipërmarrjes, datë 26.09.2019, me shoqëritë “{***}” dhe “{***}”; Shkresa nr. {***}, datë 26.09.2019, e Drejtorit të Përgjithshëm të Kadastrës, z. A. L.; Shkresa nr. {***}, datë 30.09.2019, e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Shkodër.

protokolluar nga Komisioni me nr. {***} prot., datë 29.04.2020, si dhe kërkoi të lejohet paraqitja e shqyrtimi i disa provave të reja².

8. Nga shqyrtimi i akteve të paraqitura, bashkëlidhur ankimit dhe në parashtrime, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në kushtet e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, si dhe ato nuk përmbajnë ndonjë të dhënë apo fakt që do të ndikonte në analizën financiare apo shqyrtimin e çështjes në tërësi në kuadër të nenit 49, pikës 6 të ligjit nr. 84/2016.³ Në përfundim, vlerësoi se aktet shkresore të paraqitura nuk plotësojnë kriteret e parashikuara nga dispozitat e sipërcituara për të gëzuar statusin e provës dhe nuk ndikojnë në shqyrtimin e çështjes në tërësi.

A. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit me natyrë procedural

9. Në lidhje me shkakun e ankimit se vendimi i Komisionit është rezultat i një procesi të paragjykuar, si dhe i mosbërjes së një analize të provave të paraqitura nga ana e tij gjatë procesit, trupi gjykues vlerësoi se këto pretendime të subjektit të rivlerësimit janë të pabazuara në prova dhe fakte, pasi referuar përmbajtjes së vendimit objekt shqyrtimi vihet re se ky vendim është marrë në analizë të akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se Komisioni ia ka nënshtruar vlerësimit të tij provat e depozituara nga subjekti, duke marrë qëndrim mbi vlerën provuese të tyre është çmuar prej tij ndikimi apo efekti që ato kanë mbi çështjet e ngritura, në zbatim të parimit të parashikuar nga neni 81 i Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit: “*Organi publik çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ*”. Me sa pohon vetë subjekti në faqen 42 të ankimit “*Megjithatë, me shpjegimet dhe provat që kam sjellë në vlerësimin tim, këto “gjetje” të Komisionit janë sqaruar plotësisht, prandaj dhe shumë prej tyre janë marrë parasysh nga Komisioni*”, pranon marrjen në konsideratë nga Komisioni të provave dhe akteve të paraqitura prej tij.
10. Lidhur me pretendimin e mësipërm, trupi gjykues çmon se nga Komisioni është bërë analizë konform ligjit, duke u bazuar në prova të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe në asnjë rrethanë nuk jemi përpara faktit që mungon vlerësimi i këtyre provave, pasi vendimmarrja nga ana e Komisionit, në ngarkim të subjektit të rivlerësimit Gjovalin Përnoca, është bërë mbi bazën e vlerësimit të provave dhe ka qenë i drejtë.
11. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit nuk është arsyetuar bindshëm dhe është i pasaktë në disa pjesë të tij, madje është “*parashtrim i shtrembëruar i fakteve në aket e nxjerra*”, gjë që përbën shkak për përgjegjësi disiplinore për anëtarët e Komisionit, duke cituar një paragraf të vendimit të Komisionit në faqen 5 të tij mbi raportin e ILDKPKI-së, ku sipas subjektit të rivlerësimit, është i pasaktë. Në mbështetje të këtij argumenti, subjekti i rivlerësimit ka sjellë për analogji trajtime të rasteve nga praktika e GjEDNj-së dhe Gjykatës Kushtetuese, duke sqaruar rëndësinë e veçantë të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, si pjesë e garancive të procesit të rregullt ligjor, sipas neneve 6 dhe 1 të KEDNj-së. Në lidhje me këtë shkak ankimi, trupi gjykues konstaton se vërtet ekziston një pasaktësi në faqen nr. 5 të këtij

² Përgjigja e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës nr. {***} prot., datë 04.12.2020; Leje Legalizimi nr. {***}, datë 10.12.2020; Certifikatë Pronësie nr. {***}, datë 16.12.2020.

³ Në nenin 49, pika 6 të ligjit nr. 84/2016, citohet shprehimisht: “*Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelimit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: a) marrja e provës duket se është e panevojshme; b) fakti që kërkohet të provohet është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjykimit; c) mjeti i provës është tërësisht i papërshtatshëm ose i paarrtshëm; ç) bëhet me qëllim zvarritjen e gjykimit; d) pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit*”.

vendimi, mbi konkluzionet e arritura nga ana e ILDKPKI-së për pasuritë e subjektit të rivlerësimit, por në faqen nr. 2 të vendimit të Komisionit është pasqyruar saktë e në mënyrë të detajuar konkluzioni i ILDKPKI-së, duke cituar edhe shkresën e ardhur nga ILDKPKI-ja mbi konkluzionin e pasurisë dhe, për këtë arsye, vlerëson se kjo pasaktësi mund të konsiderohet si gabim material, i cili nuk mund ta cenojë vendimin e Komisionit në tërësinë e tij.

12. Subjekti pretendon se *e gjithë procedura e hetimit administrativ ka filluar, ka vazhduar dhe është përfunduar nga të njëjtët anëtarë të trupit gjykues, të cilët kanë marrë pjesë dhe kanë dhënë vendimin përfundimtar, ky fakt përbën shkelje flagrante të parimit të paanësisë të trupit gjykues i garantuar nga Kushtetuta e Shqipërisë, neni 6, pika 1 e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjit nr. 84/2016, si dhe Kodi i Procedurave Administrative. Gjithashtu, pretendon se Kolegji, duhet të orientonte Komisionin që trupi gjykues që kryen hetimin administrativ të jetë i ndryshëm nga ai që gjykon çështjen dhe merr vendimin përfundimtar. Sipas subjektit, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në disa vendime të saj, ka theksuar rëndësinë që paraqet parimi i paanësisë së organit publik, ku një prej elementëve më të rëndësishëm të tij është edhe fakti që i njëjti organ ose të njëjtët persona nuk mund të bëjnë pjesë edhe si trupë akuzuese edhe si trupë vendimmarrëse në të njëjtën çështje. Subjekti pretendon se vendimi i Komisionit nuk është marrë nga një gjykatë e krijuar me ligj, sipas kërkesave të nenit 42 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 6 të KEDNj-së dhe duke qenë se kjo shkelje cenon zhvillimin e një “procesi të rregullt ligjor”, ky vendim, sipas tij, duhet të konstatohet si absolutisht i pavlefshëm nga Kolegji, në zbatim të germës “a”, të nenit 108 të Kodit të Procedurave Administrative.*
13. Trupi gjykues çmon se pretendimet e mësipërme të subjektit të rivlerësimit lidhen me funksionimin dhe organizimin e institucioneve që realizojnë procesin e rivlerësimit, sipas parashikimeve kushtetuese dhe ligjore dhe jo me veprime apo mosveprime konkrete të Komisionit, që lidhen me rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit individualisht. Sjellim në vëmendje se përputhshmëria e veprimtarisë së institucioneve që kryejnë procesin e rivlerësimit me parimet e nenit 6 të KEDNj-së në drejtim të garantimit të pavarësisë dhe paanësisë është certifikuar në fillim të procesit nga Komisioni i Venecias⁴, ka kaluar testin e kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese⁵ dhe së fundmi edhe çështja e gjykatës së krijuar me ligj është konfirmuar nga shqyrtimi në praktikë nga GJEDNj-ja në vendimin që i përket Xhoxhaj kundër Shqipërisë⁶. Në këtë të fundit, GJEDNj-ja nuk konstatoi shkelje të nenit 6/1 të KEDNj-së, lidhur me mënyrën e funksionit të Komisionit dhe Kolegjit. Përpos kësaj, në kushtet kur vendimi i Komisionit i nënshtrohet shqyrtimit të hollësishëm nga ana e Kolegjit, garancitë për një proces të rregullt ligjor dhe për një gjykim efektiv dhe të paanshëm adresohen edhe nga Kolegji. Pretendimin për cenim të procesit të rregullt ligjor, për shkak se e njëjta trupë gjykuese heton, shqyrtton dhe vendos, trupi gjykues e gjen të pabazuar në kushtet kur mënyra e funksionimit të institucioneve të rivlerësimit i është nënshtuar tashmë filtrave të analizës së kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë.
14. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit, që Kolegji të nxjerrë një vendim orientues për Komisionin në mënyrë që hetimi administrativ dhe gjykimi të kryhen nga trupa të tjerë gjykues, trupi gjykues në Kolegj e vlerëson të gabuar, pasi për mënyrën e organizimit e funksionimit të Komisionit, si një ndër organet e rivlerësimit, është parashikuar në Kushtetutë, në Aneksin e saj dhe në ligj. Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 kanë parashikuar rastet dhe mënyrën që Kolegji mund të korrigjojë çdo gabim procedural të kryer nga ana e Komisionit,

⁴ [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)036-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)036-e).

⁵ Shih vendimet nr. 2/2017 dhe nr. 78/2017: http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php.

⁶ <https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22tabview%22:%7B%22document%22%7D%22itemid%22:%7B%22001-208053%22%7D%7D>

duke pasur parasysh procedurën e ndjekur nga Komisioni dhe mënyrën e zbatimit të ligjit, me qëllim respektimin e të drejtave dhe parimeve themelore të subjektit të rivlerësuar.

15. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni, duke marrë të mirëqenë konkluzionet e njësisë së saj ekonomike, duke injoruar pa asnjë argument profesional konkluzionet e marra nga subjekti, duke mos pranuar marrjen e provës vendimtare, ka shkelur hapur parimin e “barazisë së armëve juridike”, për kriterin e kontrollit pasuror. Sipas subjektit të rivlerësimit realizimi i ekspertimeve nga këshilltarët ekonomikë të Komisionit është i kontestueshëm, pasi ata jo vetëm nuk marrin asnjë pyetje nga subjektet, por duke qenë nën varësinë e organit që kryen hetimin dhe gjykimin e çështjes, nuk mund të jenë të paanshëm e aq më pak të besueshëm në përfundimet e tyre.*
16. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues çmon se anëtarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor ushtrojnë veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në kuadër të procesit të vendimmarrjes sipas ligjit, por nuk janë vendimmarrës në këtë proces. Për pretendimin e subjektit, lidhur me provat dhe barazinë e armëve juridike në proces, nga shqyrtimi i akteve në fashikujt gjyqësorë, konstatohet se Komisioni, me vendimin e datës 17.07.2019, ka pranuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit të datës 16.07.2019, për shtyrjen e afatit “për paraqitjen e provave dhe shpjegimeve”, pasi i duhej më shumë kohë për të siguruar prova shtesë, gjithashtu, Komisioni ka vendosur shtyrjen e seancës dëgjimore të caktuar të datës 30.07.2019, duke marrë në konsideratë kërkesën e subjektit të rivlerësimit, për kohë shtesë për marrjen e provave të reja, duke garantuar në këtë mënyrë parimin e barazisë së armëve. Për sa konstatuar, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.
17. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni, duke aplikuar masën ekstreme ndaj tij, pa marrë parasysh natyrën e shkeljeve, kohën e kryerjes së tyre, kohëzgjatjen dhe kontributin e subjektit në sistemin gjyqësor, gjatë së cilës ka përballuar me sukses detyra të ndryshme (si prokuror, gjyqtar rrethi e apeli, kryetar gjykate në disa rrethe, inspektor e, më pas, anëtar i KLD-së), për një periudhë 27-vjeçare pune pa ndërprerje e pa asnjë masë disiplinore, subjekti i rivlerësimit pretendon se masa e dhënë nuk është proporcionale me shkeljet e pretenduara dhe ato të konstatuara, duke u shkelur dukshëm “parimi i proporcionalitetit”. Shkelja e parimit të proporcionalitetit passjell paligjshmërinë e aktit administrativ, referuar nenit 109 shkronja “c” të Kodit të Procedurave Administrative, pasi, sipas subjektit, moskonfirmimi i tij në detyrë nuk ka ndjekur përshtatshmërinë, domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e masës në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 12 të Kodit të Procedurave Administrative dhe të standardeve të KEDNj-së.*
18. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues vlerëson se parimi i proporcionalitetit, i pretenduar nga subjekti i rivlerësimit si i shkelur nga Komisioni, nuk lidhet me rrethanat e rastit konkret, pasi qëllimi i procesit të rivlerësimit nuk është vlerësimi, nëse subjektet kanë ushtruar këtë detyrë për një kohë të gjatë apo mënyrën e ushtrimit të funksionit të tyre, por subjektet ngarkohen me përgjegjësi disiplinore, sipas Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, për sa i përket pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Në rastin konkret nuk gjen zbatim parimi i proporcionalitetit, pasi ky parim është zbatuar në Kolegj, në kuadrin e vlerësimit të çështjes në tërësi dhe jo për sa pretendon subjekti i rivlerësimit në ankimin e tij.
19. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se gjatë zhvillimit të procesit të rivlerësimit në Komision i është kufizuar e drejta e mbrojtjes me avokat, pasi gjatë seancës dëgjimore të datës 10.09.2019, avokatit të tij iu dha fjala vetëm dy herë për procedurë, por nuk ia dhanë fjalën për konkluzionet, për trajtimin e ligjshmërisë së procesit dhe për elemente të veçantë të raportit paraprak të Komisionit. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit pretendon se kufizimi i të drejtës së*

tij për mbrojtjen me avokat ka ndodhur dhe për faktin se në kohën kur i është komunikuar vendimi i Komisionit, pra, më datë 15.04.2020, ka qenë periudhë për të cilën ishte shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, për shkak të pandemisë, duke e bërë të pamundur atë për të punuar me avokatin, me ekspertin financiar, me ekspertë ndërtimi, me vështirësi për të kërkuar dhe mbledhur dokumentacionin në organe shtetërore.

20. Lidhur me këtë shkak ankimi, nga shqyrtimi i akteve në dosje dhe referuar kronologjisë kohore të zhvillimit të procesit, konstatohet se Komisioni ka zhvilluar procesin e mbledhjes së provave, verifikimit, analizës dhe shqyrtimit për të tria kriteret e rivlerësimit për subjektin përgjatë periudhës maj 2018 - qershor 2019. Mes subjektit të rivlerësimit dhe Komisionit ka pasur komunikim të vazhdueshëm, nëpërmjet të cilit ai ka dhënë sqarime, informacion dhe përcjellë dokumentacion provues në përgjigje të pyetësorëve dhe të barrës së provës kaluar atij me rezultatet e hetimit administrativ. Nga sa është administruar në dosjen gjyqësore në Komision, rezulton se subjektit të rivlerësimit i është dhënë e drejta e njohjes së akteve, ka ushtruar të drejtën e mbrojtjes duke dhënë shpjegime, ka përcjellë dokumente dhe akte në cilësinë e provave dhe, së fundmi, është dëgjuar në seancën dëgjimore. Në përmbledhje sa më sipër, rezulton se subjektit të rivlerësimit i janë ofruar të gjitha garancitë për një proces të rregullt ligjor gjatë gjithë procedurës së rivlerësimit në Komision.
21. Pas analizimit të procesverbalit të seancës dëgjimore të datës 10.09.2019, trupit gjykues i rezulton se Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të depozitojë një kopje të parashtrimeve të tij me shkrim pranë sekretarisë, rezulton, gjithashtu, se pas shpjegimeve të relatorit të çështjes, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë të hollësishme të gjithë pretendimet e tij dhe më pas, i është përgjigjur pyetjeve të relatorit dhe vëzhguesit ndërkombëtar në mbyllje të shpjegimeve, duke mos pretenduar ndonjë kërkesë procedurale më tej. Në prezencë të mbrojtësit të tij ka cituar: [...], *ju falënderoj për procesin e rregullt dhe për mundësinë e plotë për të thënë ato për të cilat më pyetët.*
22. Sa më sipër, duke pasur parasysh parimin e procesit të rregullt ligjor, referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese⁷ dhe GjEDNJ-së⁸, mbi gjykimin kontradiktor dhe barazinë e armëve për rëndësinë e veçantë që merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e arsyeshme që u jepet palëve për të paraqitur deklaratimet, provat dhe vlerësimet ligjore të lidhura me çështjen që shqyrtohet, sikurse e ka trajtuar edhe subjekti i rivlerësimit në ankimin e tij, nga trupi gjykues konstatohet, që pretendimet e subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka cenuar parimet e procesit të rregullt, nuk qëndrojnë, pasi janë të pambështetura në faktet e provuara mbi bazën e provave të administruara.
23. Trupi gjykues i Kolegjit vendosi shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi mbi gjendjen që janë aktet konform nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, pasi referuar shkaqeve procedurale të ankimit dhe akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur ankimit dhe parashtrimeve, vlerësoi se nuk ndodhemi në asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 51, pika 1 e ligjit të sipërcituar, për ta trajtuar çështjen në seancë gjyqësore publike.

⁷ Vendimi nr. 21, datë 16.04.2015; vendimi nr. 34, datë 29.05.2015; vendimi nr. 37, datë 30.06.2016 etj.

⁸ *Shih Ruiz-Mateos kundër Spanjës; McMichael kundër Mbretërisë së Bashkuar; Vermeulen kundër Belgjikës; Lobo Machado kundër Portugalisë; Kress kundër Francës, etj.*

B. Vlerësimi i Kolegjit për kriterin e pasurisë

*B.1. Lidhur me pasurinë “apartament banimi”, me sipërfaqe 108,40 m² dhe “dy garazhe”, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, porositur në bashkëpronësi me z. A. G., sipas kontratës së porosisë, datë 31.12.2005, në vlerën 49.860 euro*

24. Komisioni, për këtë pasuri, ka konkluduar se:

- Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2005 një “trajtimin preferencial” që i është bërë nga shtetasi A. G., i cili i ka siguruar subjektit një apartament me çmim të favorshëm, duke paguar fillimisht personalisht të gjithë çmimin e apartamentit, megjithëse ishte bashkëporositës me subjektin e rivlerësimit, duke i dhënë subjektit si mundësi shlyerjen e çmimit të apartamentit, me mundësi pritjeje për likuidimin, duke qenë kështu në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.
- Komisioni, bazuar në dokumentacionin e administruar dhe në udhëzimin e EKB-së, ka vlerësuar se çmimi i blerjes së apartamentit, deklaruar nga subjekti dhe i pasqyruar në kontratën e sipërmarrjes të datës 31.12.2005, në vlerën 41.860 euro, nuk është çmimi real i blerjes së apartamentit nga subjekti, për arsyen se ky çmim rezulton të jetë shumë më i ulët krahasuar me çmimin e referencës të pasqyruar në Udhëzimin nr. 5, datë 23.11.2005, të Këshillit të Ministrave, që rezulton i përlogaritur në vlerën 75.593 euro, çka përforcon bindjen se kemi të bëjmë me një situatë trajtimi preferencial dhe të padeklaruar nga subjekti i rivlerësimit.
- Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur burime të mjaftueshme të ligjshme financiare për të justifikuar investimet, kursimet dhe shpenzimet e kryera për vitin 2005, duke rezultuar me balancë financiare negative në vlerën - 228.532 lekë. Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur burime të mjaftueshme të ligjshme financiare për blerjen e apartamentit në vlerën 49.860 euro, në vitin 2006.

25. Në ankimin e tij, subjekti i rivlerësimit pretendon se kontratën e porosisë për këtë pasuri nuk e ka deklaruar si “trajtim preferencial” në deklaratën e interesave privatë periodikë 2005, [faqe nr. 7 të formularit], por e ka pasqyruar si një kontratë të thjeshtë porosie, pasi ka pasur bindjen se po e blinte këtë pronë mbi koston reale, rreth dyfishin e saj dhe nuk po përfitonte asgjë nën kosto. Sipas subjektit, kjo kontratë ishte një veprim juridik i zakonshëm, pasi nuk ishte në kushtet e detyrimit për ta trajtuar si dhuratë.

25.1. Lidhur me konkluzionin e Komisionit, për sa i përket vlerës reale të kësaj banese, subjekti pretendon se, pavarësisht që në kontratën paraprake (porosie) është shënuar sipërfaqja e banesës prej 119,6 m², siç verifikohet në kontratën përfundimtare (kontratën e shitblerjes së datës 07.06.2017, apartamenti ka sipërfaqe 108,40 m² dhe çmim shitje 41.860 euro), pra, sipas subjektit kjo pronë është shitur me 386,16 euro/m² ose referuar kursit të euros në atë kohë (EUR/ALL= 123,006), me 47.500 lekë/m².

25.2. Sipas pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, konkluzioni i Komisionit, që çmimi i apartamentit të blerë nga subjekti për 41.860 euro është shumë më i ulët se çmimi referues i miratuar nga Enti Kombëtar i Banesave [në vijim “EKB”], nuk është i saktë, pasi në atë vit nuk ka pasur çmim të referencës për shitjet e pronave, çmimi i referencës i përcaktuar në vitin 2005, në vlerën 77.452 lekë, nuk ka qenë i zbatueshëm, pasi vetëm me udhëzimin nr. 1, datë 20.08.2008, është bërë për herë të parë ndarja e çmimit të referencës, sipas zonave të qytetit të Tiranës.

25.3. Ndryshe nga sa konkludon Komisioni, subjekti i rivlerësimit pretendon se *e ka blerë këtë pronë mbi koston reale të ndërtimit të tij, pasi referuar Udhëzimit nr. 5, datë 23.11.2005, kjo kosto ka qenë 28.756 lekë për m dhe, për pasojë, blerja e këtij apartamenti, sipas subjektit, ka qenë sa dyfishi i koston së ndërtimit të kësaj banese [47.500 - 28.756 = 28.708,5 lekë]. Sipas subjektit të rivlerësimit, i cili i referohet deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.07.2019, të z. A. G., si dhe pesë kontratave të shitblerjes bashkëlidhur deklaratës noteriale, rezulton se shoqëria ndërtuese, më datë 30.06.2003, ka bërë shitje apartamentesh, me çmime më të ulta se sa vlera me të cilën subjekti i rivlerësimit ka blerë shtëpinë.*

25.4. Subjekti i rivlerësimit thekson se në rastet kur shuma monetare e vënë si çmim i banesës likuidohet menjëherë, që në datën e lidhjes së kontratës, është normale që edhe çmimi të jetë më i ulët se sa kur likuidohet me këste, madje edhe EKB-ja, me akte nënligjore, bënte zbritje 30% të çmimit në rast të likuidimit të menjëhershëm dhe sipas llogaritjeve të tij⁹ rezulton një çmim jo i ulët. Si argument, subjekti i rivlerësimit sjell edhe faktin që apartamenti në momentin e blerjes nuk ka pasur certifikatë pronësie [ka nënshkruar kontratën e sipërmarrjes në vitin 2005, kurse kontratën e shitblerjes e ka nënshkruar në qershor 2017, pas 12 vjetësh nga momenti i porosisë].

25.5. Sipas subjektit të rivlerësimit, kontrata noteriale e porosisë e datës 31.12.2005 është dokument zyrtar me fuqi të plotë provuese dhe vënia në dyshim e provës shkrese bie në kundërshtim me nenin 253 të Kodit të Procedurës Civile¹⁰. Në mbështetje të sa sipër, subjekti citon vendime e tjera të Komisionit, në të cilat nuk janë marrë në konsideratë vlerat e deklaruara prej subjekteve të tjerë të rivlerësimit, por Komisioni ka marrë në konsideratë vetëm kontratën noteriale të shitjes. Gjithashtu, pretendon se të gjitha arsyet e dhëna më lart tregojnë se çmimi i blerjes së pasurisë *apartament banimi dhe dy garazhe* nga ana e tij ka qenë një çmim tregu, aspak favorizues.

25.6. Për konkluzionin e Komisionit në vendimin e ankimuar, objekt shqyrtimi, se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur rezultojnë me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar investimet, kursimet dhe shpenzimet e kryera për vitin 2005, duke rezultuar me balancë financiare negative në vlerën - 228.532 lekë, subjekti ngre pretendimet:

- se ky vit rezulton me bilanc pozitiv, nëse do të merret në konsideratë e ardhura e bashkëshortes së tij për një punë jashtë orarit e bërë në entin botues shoqëria “{***}” ShPK me NIPT {***}, e ardhur që, sipas subjektit të rivlerësimit, dokumentohet me vërtetimin¹¹ e datës 14.08.2019, të punëdhënësit, shoqërisë “{***}” ShPK;
- se nuk mund të penalizohet për mosnjohjen nga Komisioni të këtyre të ardhurave të bashkëshortes nga puna e ligjshme, me faktin se nuk janë paguar detyrimet tatimore përkatëse, pasi referuar nenit 117 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës i Shqipërisë”, nenit 6 të ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenit 10 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i

⁹ Duke marrë çmimin prej 41.860 euro + (30% x 41.860 euro) = 54.418 euro, pjesëtuar me sipërfaqen prej 108.40 m² = 502 euro/m² ose e konvertuar në lekë (502 EUR x 123.006 ALL/EUR) = 61.747 lekë/m².

¹⁰ Në nenin 253 të Kodit të Procedurës Civile citohet shprehimisht: “Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar”.

¹¹ Në vërtetimin e datës 14.08.2019, shoqëria “{***}” ShPK shprehet se: “Vërtetojme se znj. A. P. ka punuar pranë kompanisë sonë part-time si redaktore, për hedhjen e publikimeve të Fletores Zyrtare në faqen e internetit të QBZ Tiranë. Për punën e kryer gjatë vitit 2005 ajo është shpërblyer në shumën 270.000 lekë”.

ndryshuar, parashikohet se është detyrim i punëmarrësit mbajtja dhe pagimi i tatimit mbi të ardhurat, si dhe kontributi i sigurimeve shoqërore e shëndetësore;

- se është fakt që bashkëshortja e tij ka përfituar të ardhurat nga pagat, madje i janë bërë ndalesat përkatëse mbi pagën *bruto*, por agjenti i mbajtjes së tatimit (punëmarrësi), pavarësisht se e ka mbajtur tatimin, nuk e ka deklaruar dhe derdhur këtë tatim. Penalizimi nga ana e Komisionit për një shkelje financiare, e cila në kohën e kryerjes mund të kishte sanksione të ndryshme, por jo mosnjohje si e ardhur e ligjshme për justifikim të pasurisë, sipas subjektit të rivlerësimit, bie në kundërshtim me parimin kushtetues të “sigurisë juridike”.

26. Nga aktet e dosjes gjyqësore, lidhur me shkaqet ankimit për këtë pasuri, trupi gjykues i Kolegjit çmon se:

26.1. Në kontratën e sipërmarrjes së datës 31.12.2005, lidhur mes shoqërisë sipërmarrëse “{***}” ShPK dhe porositësve A. G. e Gjovalin Përnoca, rezulton se objekt i kësaj kontrate është porositja e apartamentit të banimit me sipërfaqe 119,6 m², kati i VIII-të, si dhe 2 (dy) garazhet në katet nëntokë me nr. {***} dhe nr. {***}, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë.

26.2. Sipas kontratës së sipërmarrjes, në pikën 2.1 të saj, çmimi i apartamentit është caktuar 41.860 euro, ndërsa çmimi për garazhet është përcaktuar në vlerën 8.000 euro. Në pikën 3 të kontratës së sipërmarrjes “*Mënyra e pagesës*” parashikohet se: “*Pagesa për vlerën e apartamentit dhe garazhit objekt i kësaj kontrate është likuiduar krejtësisht nga porositësit dhe se pala sipërmarrëse deklaron se i ka marrë të gjitha të hollat në dorë dhe nuk ka asnjë pretendim për këtë vlerë të likuiduar jashtë kësaj zyre*”. Likuidimi tërësor i vlerës së apartamentit provohet me mandatarkëtimin nr. {***}, datë 31.12.2005, referuar të cilit rezulton të jetë arkëtuar nga shtetasi A. G., shuma prej 49.860 euro, me përshkrimin “për apartament, kati VIII, objekti 5-katësh + garazh”, për shoqërinë “{***}” ShPK.

26.3. Kalimi i pronësisë së apartamentit, me sipërfaqe 108,40 m² me çmimin 41.860 euro, të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, në emër të subjektit të rivlerësimit, është realizuar me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.06.2017, me shitës shoqërinë “{***}” ShPK dhe blerës Gjovalin Përnoca, kurse kalimi i pronësisë për dy garazhet me sipërfaqe 19,20 m², përkatësisht, të porosituara së bashku me apartamentin e sipërcituar, është realizuar me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.11.2017, nënshkruar mes palëve, si më sipër, kundrejt çmimit 4.000 euro secili.

26.4. Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.04.2006, z. A. G. deklaron, ndër të tjera, se *nga ana e tij është paguar shuma prej 49.860 euro, sipas mandatit të sipërpërmendur dhe “sot më datë 24.03.2006, deklaron se heq dorë plotësisht nga kontrata e sipërmarrjes, duke ia kaluar të gjitha të drejtat dhe detyrimet mbi këto pasuri z. Gjovalin Përnoca”*. Në vijim të të njëjtës deklaratë, shpjegon se *sot mori në prezencën e noteres shumë prej 15.000 euro dhe diferenca tjetër do të likuidohet me pjesë, sipas mundësisë nga Gjovalin Përnoca, por jo më vonë se momenti i marrjes së çelësave në dorë, ndërkohë, që subjekti i rivlerësimit Gjovalin Përnoca në të njëjtën deklaratë shprehet se është dakord me sa deklaron më sipër A. G.* Ndërsa në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.01.2007, z. A. G. deklaron, ndër të tjera, se *sasia tjetër e të hollave në vlerën prej 34.860 eurosh i është likuiduar nga Gjovalin Përnoca pjesë-pjesë, ku kësti i fundit është likuiduar në dhjetor 2006, jashtë kësaj zyre*.

26.5. Me pyetësorin nr. 4 të datës 14.05.2019, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit shpjegime në lidhje me: *arsyen e porositjes së apartamentit dhe dy garazheve nga dy porositës solidarë; arsyen përse A. G. bëri pagesën e të gjithë vlerës së apartamentit dhe garazheve dhe, më pas, hoqi dorë thujse menjëherë nga këto pasuri; cili është burimi i krijimit të shumës*

15.000 euro paguar në datën 24.03.2006 dhe shumës 34.860 euro, paguar pjesë-pjesë, si dhe këstin e fundit të paguar në muajin dhjetor 2006 A. G.; paraqitjen e dokumentacionit justifikues të krijimit të dy shumave dhe sqarime në çrrethana subjekti është njohur me A. G.. Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ në Komision¹², ka dhënë shpjegime mbi pyetjet e mësipërme, në përgjigjet e tij më datë 22.05.2019.

26.6. Lidhur me këtë pasuri, në deklaratën e pasurisë vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Me kontratën e porosisë, datë 31.12.2005, unë Gjovalin Përnoca dhe z. S. G. bëmë një kontratë porosie me sipërmarrësin ‘{***}’, z. P. F., për të blerë në bashkëpronësi një apartament dhe 2 garazhe (një por më i madh), në rrugën ‘{***}’, për vlerën 49.860 euro, të cilat janë likuiduar, po atë ditë, nga z. S. G. (pasi ai hyri që të më ndihmonte mua duke ia blerë ish-ortakut të tij, z. P. F., për një çmim më të ulët, pasi unë nuk kisha lekë në dorë për ta blerë ndërsa z. G. do të më priste). Më datë 05.04.2006 me deklaratën noteriale, unë i kam likuiduar z. G. shumën 15.000 euro, ndërsa ai ka hequr dorë nga kontrata duke më lënë porositës të vetëm, si dhe duke iu detyruar atij për diferencën 35.000 euro deri në përfundim të objektit...dhe me pjesën tjetër janë likuiduar edhe 34.860 euro ndaj z. S. G. me deklaratën noteriale të datës 31.12.2006, duke mos ngelur as hua e as gjendje në fund të vitit, asnjë lekë. Në këtë shtëpi banoj që nga viti 2008. Është regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, me certifikatën e pronësisë, datë 02.10.2016”. Në rubrikën “Vlera me shifra dhe fjalë” deklaroi: “49.860 euro (dyzet e nëntë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë)”. Në rubrikën “Pjesa në %”, deklaroi: “50 % me gruan”.

26.7. Në deklaratën e interesave private periodikë vjetorë 2005, subjekti i rivlerësimit deklaroi: “Kontratë porosie për një apartament me sipërfaqe 119,6 m² e garazh 20 m², në Tiranë, me kontratën e datës 31.12.2005, të noterit V. S., në ndërtim nga firma ‘{***}’, me pronar P. F.. Shënim: me M.A., nr. {***}, datë 31.12.2005, e gjithë vlera është likuiduar nga porositësi A. G. në arkën e firmës sipërmarrëse, ndërsa detyrimet midis meje dhe porositësit A. G. i kemi zgjidhur me veprime juridike të mëvonshme”. Në rubrikën “Vlera me shifra dhe fjalë” deklaroi: “49.860 euro (dyzet e nëntë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë)”. Në rubrikën “Pjesa në %”, deklaroi: “Bashkëpronar me A. G. me 50% të vlerës”.

26.8. Në analizë të fakteve dhe rrethanave të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se ka një diferencë të konsiderueshme çmimi i shitjes për këtë pasuri, duke krahasuar çmimin e përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes me çmimet mesatare për shitjen e apartamenteve në qytetin e Tiranës, të përcaktuara në Udhëzimin nr. 5, datë 23.11.2005, të Këshillit të Ministrave.

26.9. Pavarësisht pretendimit të subjektit të rivlerësimit se çmimi i referencës i përcaktuar në vitin 2005 nuk ka qenë detyrues, por referues, pasi vetëm me Udhëzimin nr. 1, datë 20.08.2008, është bërë për herë të parë ndarja e çmimit të referencës sipas zonave të qytetit të Tiranës, trupi

¹² Subjekti është shprehur: “Banesa u ble (u bë kontrata e porosisë në datën 31.12.2005) me porositës unë dhe A. G., sepse në momentin e përpilimit të kontratës së porosisë unë nuk kisha asnjë mundësi financiare, gjithë shumën do ta likuidonte ai dhe do më priste që ta likuidoja çmimin e banesës) pjesë-pjesë, duke mbetur unë pronari i vetëm i saj. Këtë veprim, z. G. e bëri, meqenëse më parë se të ndahej nga ortaku, (më kishte premtuar që do më shiste një banesë në atë pallat, pra, për të mbajtur premtimin e tij), për të më krijuar mundësinë që ta blej këtë shtëpi me çmim të arsyeshëm dhe me mundësi pritjeje për likuidim, me qëllim që pas lidhjes së kontratës të hiqte dorë nga bashkëpronësia dhe do mbetesh pronar i vetëm i saj”.

“Të gjitha pagesat e kanë origjinën te kursimet nga pagat vjetore të mia dhe bashkëshortes... Si dokumentacion ligjor kam kontratat dhe deklaratat noteriale të përmendura....Me z. A. G. njihem që në vitet 2000, në rrethana që nuk i mbaj mend saktësisht, por nga shokë të përbashkët, besoj se kolegë të mi nga Shkodra, të cilët i kishin transmetuar për mua opinione pozitive. Theksoj se unë asnjëherë nuk kam gjykuar ndonjë çështje penale apo civile të tij apo të afërmve të tij, si dhe nuk kam pasur ndonjë marrëdhënie tjetër biznesi. Nuk kemi frekuentim të rregullt shoqëror, pasi secili ka angazhimet e tij, por nëse shihemi ndonjëherë, ruajmë konsiderata reciproke”.

gjykues vlerëson se marrja në konsideratë për përllogaritje nga Komisioni, e çmimit mesatar të përcaktuar në Udhëzimin nr. 5, datë 23.11.2005, të Këshillit të Ministrave¹³, ku në tabelën nr. 2, përcaktohen të dhënat për çmimin e shitjes në tregun e lirë të banesave dhe, konkretisht, për qytetin e Tiranës rezulton në vlerën 77.452 lekë/m², është një standard i arsyeshëm për referim, si dhe një tregues për diferencën e lartë që ekziston midis çmimit të përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes krahasuar me çmimet mesatare, sipas VKM-së së sipërcituar. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se e ka blerë me një çmim të lirë apartamentin, duke iu referuar kostos mesatare të ndërtimit, sipas Udhëzimit nr. 5, datë 23.11.2005, nuk qëndron.

26.10. Trupi gjykues i Kolegjit, duke iu referuar shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit në ankim dhe në parashtrime të depozituara në Kolegj, por edhe në Komision, i vlerëson si jo të besueshme veprimet e tij, mbi këtë pasuri, mbi arsyet se pse shtetasi A. G. pranoi të paguajë shumën prej 49.860 eurosh për blerjen e apartamentit dhe dy garazhet pranë shoqërisë “{***}” ShPK, në vitin 2005, me qëllim përfitimin e këtij apartamenti në favor të subjektit të rivlerësimit dhe të pranojë likuidimin pjesë-pjesë të shumës nga ana e subjektit të rivlerësimit pa asnjë dokumentacion justifikues ligjor dhe pa argumentuar ligjërisht shkakun se pse është kryer ky veprim nga ana e tyre.

26.11. Gjithashtu, Kolegji e gjen të drejtë konstatimin e Komisionit mbi çmimin jo real të blerjes së kësaj pasurie, pasi nuk përputhet me çmimin mesatar të shitjes së apartamenteve në tregun e lirë në Tiranë të përcaktuar në Udhëzimin nr. 5, datë 23.11.2005, të Këshillit të Ministrave, duke e konsideruar përfitimin e kësaj pasurie nga ana e subjektit të rivlerësimit si trajtim preferencial.

- 27.** Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit pretendon të ketë kryer likuidimin e vlerës së apartamentit në shumën 49.860 euro, gjatë viteve 2005 dhe 2006, duke kryer këto transaksione:

27.1. *Më datë 09.02.2006, me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., e shitëm shtëpinë në {***} me shitës A. P. e blerës N. D., për vlerën 3.400.000 lekë (e mobiluar, por duheshin shlyer huat)... dhe më datë 05.04.2006 i dhamë z. S. G. 15.000 euro dhe bleva një makinë “Polo”, 1,4 me targë {***}, për 200,000 lekë. Nga pagat e vitit 2006 morëm 2.260.465 lekë. Llogaritja është 2.260.463 lekë nga pagat + 3.400.000 lekë nga shitja + 1.400.,000 lekë nga viti 2005 = 7.060.000 lekë heqim 200.000 lekë për blerjen e makinës=6.860.000 lekë, prej tyre zbresim 15.000 euro që dhamë në prill dhe me pjesën tjetër janë likuiduar edhe 34.860 euro ndaj shtetasit S. G. me deklaratë noteriale, datë 31.12.2006, duke mos ngelur as hua e as gjendje në fund të vitit asnjë lekë. Në këtë shtëpi banoj që nga viti 2008. Është regjistruar në certifikatat pronësore të datës 02.10.2016.*

27.2. Nisur nga fakti që subjekti i rivlerësimit krahas të ardhurave ka deklaruar si burim edhe të ardhurat nga shitja e apartamentit 1+1 të blerë në {***}, trupi gjykues vlerësoi të analizojë burimet e krijimit të kësaj pasurie, pasi rezultati i saj ndikon drejtpërdrejtë në analizën financiare të pasurisë objekt shqyrtimi.

27.2.1. Konkluzionet e Komisionit, për pasurinë në {***}, janë si më poshtë.

Pas analizimit të dokumentacionit të përcjellë nga ZVRPP-ja Kavajë, dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, si dhe udhëzimit të EKB-së, Komisioni ka arritur në përfundimin se mes subjektit të rivlerësimit e personit të lidhur dhe palës tjetër në kontratën e blerjes dhe të shitjes së apartamentit në {***}, Durrës, janë caktuar çmime fiktive, si për

¹³ Udhëzimi nr. 5, datë 23.11.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave në tregun e lirë të banesave dhe koeficientit K”,

blerjen, ashtu edhe për shitjen e këtij apartamenti, transaksione të kryera brenda një periudhe të shkurtër kohe, ku evidentohen diferenca të konsiderueshme mes çmimit të shitjes kundrejt atij të blerjes, krahasuar ato edhe me çmimet referuese të përcaktuara në udhëzimet e EKB-së [apartamenti është blerë nga personi i lidhur me subjektin, bashkëshortja e tij, në datën 29.7.2005, në vlerën 1.900.000 lekë, është shitur nga subjekti dhe personi i lidhur me të në datën 09.02.2006, blerësit N. D. për shumën 3.400.000 lekë dhe, ky blerës, e shet këtë apartament te të tretët në datën 05.09.2006, në vlerën 1.950.00 lekë].

Komisioni, duke marrë në konsideratë faktin se në datën 31.12.2002, subjekti rezultoi me balancë financiare [të ardhura – shpenzime – pasuri] negative prej 1.422.785 lekësh, arrin në konkluzionin se subjekti nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e kursimeve ndër vite [12.000 USD të deklaruara në deklaratën e pasurisë së vitit 2004, me origjinë të pretenduar nga gjendja *cash* e deklaruar në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës 2003, me burim nga totali i të ardhurave para vitit 2003], të pretenduara si burim krijimi të pasurisë apartament ndodhur, në {***}, në diferencën negative prej 939.102 lekësh [+196.460 lekë – 1.135.562 lekë].

27.2.2. Për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit, në ankim dhe në parashtrimet e depozituara në Kolegj, vijon të mbajë të njëjtin qëndrim, si edhe në përgjigjet e dhëna prej tij pyetësorëve¹⁴ të Komisionit drejtuar subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, si dhe shpjegimet e dhëna prej tij në seancën dëgjimore, duke konfirmuar se ka blerë një banesë në plazhin e {***}, prej 58 m², kundrejt çmimit 1.900.000 lekë, për nevojat e pushimit të familjes. Sipas subjektit, kjo banesë u ble, duke pasur njohje me shitësin, me një çmim të favorshëm krahasuar me banesat e tjera në distancë nga deti, por ishte e pa mobiluar. Subjekti i rivlerësimit pretendon se, pasi e ka blerë, ka bërë investime në përmirësimin e gjendjes së shtëpisë (rregullime hidraulike, elektrike, mobilim dhe pajisje elektrike), gjithashtu, pretendon se këto punime i ka pasur parasysh në shpenzimet e vitit 2005, i ka përmendur dhe llogaritur edhe në deklarin vjetor të pasurisë të vitit 2006, (faqe 3), ku citohet se “*shtëpia u shit bashkë me pajisjet dhe orenditë*”. Ndërsa, shprehet se *mobilet e vjetra italiane i ka pasur prej vitesh në shtëpi, të blera para vitit 1997, në Shkodër, ato vetëm sa janë restauruar dhe ja kanë shtuar vlerën banesës në momentin e blerjes. Prandaj, diferenca midis çmimit të blerjes dhe çmimit të shitjes është për shkak të çmimit të favorshëm të blerjes, por pa pajisje, nga përmirësimet e brendshme të banesës, nga vlera e mobileve dhe pajisjeve, nga fakti se blerësit i pëlqeu banesa, nga tendenca e kohës, për të blerë shtëpi në plazh. Për vlerën e shpenzimeve, subjekti sqaron se nuk disponon dokumentacion justifikues të këtyre shpenzimeve, pasi këto punime i ka bërë me njerëz të afërt. Referuar bilancit të të ardhurave dhe shpenzimeve në deklarinet e tij, për vitet 2005 dhe 2006, subjekti pretendon se ka pasur mundësi financiare për përballimin e tyre. Gjithashtu, sqaron se *blerja e kësaj pasurie u bë për ta pasur dhe jo për ta shitur, po, kur krejt papritur, iu krijua mundësia për të blerë shtëpinë ku jeton sot me një ndërtesë, që do ta priste për paratë, u detyrua që të lidhë kontratën e porosisë kur akoma nuk kishte lekë, duke shitur shtëpinë e plazhit, makinën, etj., si dhe duke likuiduar huan pjesë-pjesë.**

27.2.3. Lidhur me konstatimin e Komisionit se kontrata e lidhur mes bashkëshortes së subjektit dhe blerësit N. D. ka pasur çmim jo real e fiktiv, subjekti ripërsërit qëndrimin e tij se: “*Kontratat noteriale nuk mund të vërtetohen apo kundërshtohen me dëshmitarë, ato kanë fuqi të plotë provuese për kushtet e fiksuara në kontrata, prandaj, nuk mund të vihen në dyshim për sa u përket kushteve të përcaktuara në të*”.

¹⁴ Përgjigjet e pyetësorit nr. 2, janë protokolluar nga Komisioni më datë 20.03.2019.

27.2.4. Subjekti i rivlerësimit e konsideron të gabuar konkluzionin e Komisionit se ai nuk ka pasur burime të ligjshme financiare ndër vite në shumën - 939.102 lekë (+196.460 lekë - 1.135.562 lekë), që të kenë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit në {***}, pasi nuk ka marrë parasysh asnjë argument të analizës financiare të subjektit, për të krijuar kursimet ndër vite me burime të ligjshme të pretenduara si burim krijimi të kësaj pasurie, konkretisht:

27.2.4.a. Shumën 3.200.000 lekë e ka konsideruar në emër të znj. A. P. në analizën financiare, ndërsa sipas tij këto vlera monetare nuk kanë qenë të bashkëshortes së tij, por të vajzës së vëllait të saj, znj. M. V.. Ashtu siç ka sqaruar edhe në përgjigje të pyetësorëve, kjo depozitë është krijuar në shtator 2002, pas kthimit të tij dhe bashkëshortes nga Anglia, ku kanë pranuar të marrin nga mbesa e saj M. V., shumën e të hollave prej 8.000 paund për t'ia ruajtur, si dhe është porositur që të pranojë nga familjarët e saj në Shqipëri edhe disa para të tjera të saj dhe t'ia ruante të gjitha bashkë.

27.2.4.b. Sipas subjektit, Komisioni duhet të merrte në konsideratë edhe të ardhurat në shumën 90.000 lekë të përfituara nga dietat për një periudhë 6-mujore, sipas VKM-së nr. 549, datë 7.11.1994, duke qenë se ishte emëruar në një rreth tjetër jashtë vendbanimit dhe pa strehim, si dhe shumën prej 2.400 USD, të kursyera nga dietat për trajnimin njëmuor në ShBA, në vitin 1993.

27.2.4.c. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit se ka mungesë burimesh financiare për krijimin e kursimeve në shumën 12.006,36 USD, në fund të vitit 2004, të depozituar në bankë, si dhe shumës 3.000 USD gjendje në *cash* të deklaruara në deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim 2003, pasi ato vijnë nga kursimet ndër vite, të krijuara nga burime të ligjshme.

27.2.4.ç. Lidhur me përllogaritjen e shpenzimeve jetike, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk duhej të llogarisë ato në masën 70% të të ardhurave, në asnjë rast jo më shumë se 50 % të të ardhurave.

27.3. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi dokumentacionin e administruar në fashikujt gjyqësorë, i rezultoi se subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë *vetting* [shtojca 2, 2017], ka deklaruar:

- Në fund të vitit 2004 kam pasur 15.000 USD gjendje [13.000 të ruajtura nga shitja e shtëpisë në Shkodër, [...] dhe 2.000 të kursyera nga pagat gjatë vitit.
- Më datë 24.06.2005 shita makinën tip “Benz”, me targa {***}, për shumën 200.000 lekë dhe gruaja [...] shiti me kontratën e datës 06.12.2005 makinën “Opel”, me targa {***}, për shumën 200.000 lekë.
- Me kontratën e datës 29.07.2005, me shitës S. e I. K. e blerëse A. P., blemë 1+1, në {***}, për 1.900.000 lekë (se nuk e dinim se do na duheshin për shtëpinë), 50% me gruan [...]. Nga paga ime dhe e gruas për vitin morëm 2.422.,000 lekë plus dy makinat bëjnë 2.822.000 lekë, zbresim 1.900.000 lekët e shtëpisë në {***}, mbeten 922.000 lekë të cilave duke u shtuar 15.000 USD, mbyllen shpenzimet e vitit dhe në fund të vitit 2005 kishim gjendje 1.400.000 lekë. Vlera e deklaruar e apartamentit “1,900,000 lekë”, pjesa takuese “50%”.
- Në deklaratën e interesave privatë 2004, për burimin e shumës 12.006,36 USD, të tërhequr më datë 14.03.2005, deklaroi: “Likuiditetet gjendje në bankë në fund të vitit 2004 e kanë burimin e krijimit tek paratë *cash* në shtëpinë shumën 15.000 USD, deklaruar nga subjekti në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim 2003, ku në seksionin ‘Formulari A-5, Likuiditete’, rubrika ‘Burimi’, shkruan shprehimisht nga paga ime dhe e bashkëshortes për vitet.

- Në deklaratën e interesave private periodike 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Blerje e një apartamenti 1+1, në {***}, Kavajë, me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.07.2005, e regjistruar në ZVRPP-në Kavajë me nr. {***} prot., datë 29.08.2005, vlera 1.900.000 (një milion e nëntëqind mijë lekë), në bashkëpronësi me bashkëshorten, në 50 % të vlerës”*. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e kësaj pasurie.
- Në deklaratën e interesave private periodike 2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Shitur: shtëpi 1+1, në {***} 58 m², e pajisur me orenditë, kontrata nr. {***} rep., {***} kol., datë 09.02.2006, vlera 3.400.000 (tre milionë e katërqind mijë lekë), 50%”*.

27.3.1. Në shkresën¹⁵ e përcjellë Komisionit nga ZVRPP-ja Kavajë, ndodhet kartela e pasurisë së paluajtshme që i përket pasurisë nr. {***}, vol. {***}, {***}, {***}. {***}, për sipërfaqe totale të pasurisë 58 m². Në rubrikën *“Seksioni i Pronësisë”* vërehet se janë kryer disa transaksione mbi këtë pasuri, ku fillimisht kjo pronë ka qenë në pronësi të shtetasës S. K. dhe, më pas, me datë regjistrimi 16.09.2005, është regjistruar në emër të A. Gj. P., në vlerën 1.900.000 lekë, bazuar në kontratë shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.07.2005. Më datë 16.03.2006, është regjistruar në emër të N. I. D., me vlerë 3.400.000 lekë të shkruar në rubrikën *“Shuma e Paguar”*, bazuar në kontratë shitje nr. {***} rep., {***} kol., datë 09.02.2006, kurse më datë 05.09.2006, kjo pronë është regjistruar në emër të shtetasve P. dhe S. S., në vlerën 1.950.000 lekë.

27.3.2. Trupi gjykues çmon se subjekti nuk arriti t’i vërtetojë me dokumentacion justifikues ligjor kryerjen e punimeve apo mobilimin në apartamentin në {***}, të cilat, sipas tij, kishin rritur vlerën e kësaj pasurie, duke i konsideruar si jobindëse pretendimet e subjektit.

27.3.3. Lidhur me pretendimin e subjektit, për sa i përket konstatimit të çmimit fiktiv të blerjes dhe shitjes së kësaj pasurie, trupi gjykues, pasi analizoi dokumentacionin e administruar, konstatoi që kjo pasuri është blerë me një vlerë më të ulët se ato të përcaktuara në çmimet referuese, sipas udhëzimeve të EKB-së dhe është shitur pas një periudhe 6-mujore me dyfishin e saj, vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit se nga subjekti i rivlerësimit e personi i lidhur me të, si dhe pala tjetër në kontratat përkatëse janë caktuar çmime fiktive në kontratat e blerjes dhe të shitjes, përkatësisht, duke gjetur të pabazuar pretendimin e subjektit për këtë çështje.

27.3.4. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit për llogaritjen në zërin të *ardhura* në analizën financiare edhe të të ardhurave të përfituara nga puna jashtë orarit e bashkëshortes së tij, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se, për sa kohë nuk u vërtetua me dokumentacion justifikues ligjor pagesa e tatimit në burim për këtë të ardhur të pretenduar nga paga, e gjen të drejtë qëndrimin e Komisionit për mospërfshirjen e tyre në analizën financiare të kryer, duke mos e konsideruar si të ardhur të ligjshme, në kushtet kur nuk përmbush kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

27.3.5. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga dietat, Kolegji çmon se kjo e ardhur nuk mund të merret parasysh në analizën financiare, referuar kjo edhe jurisprudencës së konsoliduar tashmë të Kolegjit¹⁶, duke vlerësuar se dieta është një e ardhur, e cila, referuar qëllimit për të cilin jepet (për shpenzime jetike thelbësore), nuk mund të kursehet.

27.3.6. Për sa i përket pretendimit të subjektit, lidhur me përlllogaritjen nga Komisioni të shumës 3.200.00 lekë si depozitë e subjektit, Kolegji çmon të drejtë konkluzionin e Komisionit, pasi

¹⁵ Nr. {***} prot., datë 07.01 2019, shkresë e ZVRPP-së Kavajë, drejtuar Komisionit.

¹⁶ Vendimi nr. 7, datë 05.04.2019 (JR) dhe vendimi nr. 9, datë 22.05.2019 (JR), i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

nga subjekti nuk u provua me dokumentacion justifikues ligjor që kjo depozitë ishte e personit tjetër të lidhur M. V. [trajtuar në paragrafin 29.2. të këtij vendimi].

27.3.7. Lidhur me pretendimet e subjektit për pamjaftueshmërinë e burimeve financiare të konstatuara nga Komisioni për krijimin e pasurisë apartament banimi, në {***}, trupi gjykues, nisur nga fakti që si në deklaratën e pasurisë *vetting*, ashtu edhe në deklaratën e interesave privatë 2005 nuk specifikohet saktë burimi i krijimit të kësaj pasurie, të blerë në vlerën 1.900.000 lekë, më datë 29.07.2005, analizoi mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur deri në momentin e krijimit të kësaj pasurie (01.01.-29.07.2005), si dhe verifikoi mundësinë financiare të tyre, për të krijuar kursimet e përdorura nga vitet e mëparshme, likuiditetet në bankë në shumën 12.000 USD të deklaruara në deklaratë e interesave privatë 2004, me burim kursimet në shumën 15.000 USD të krijuara me kursime ndër vite (1982 - 2002).

27.3.8. Trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në rezultatet e analizës financiare të kryer, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, ndodhen në kushtet e pamundësisë financiare për të realizuar kursimet e krijuara ndër vite, në shumën 12.000 USD [apo 1.135.562 lekë], që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë në {***}, si nëse shpenzimet jetike konsiderohen në masën 66% të të ardhurave nga pagat e subjektit dhe personit të lidhur, ashtu edhe nëse konsiderohen në masën 30% të të ardhurave të tyre.

27.3.9. Në përfundim, mungesa e burimeve të ligjshme, për krijimin e pasurisë apartament në {***}, rezulton në total në vlerën - 853.851 lekë, duke e vendosur subjektin e rivlerësimit, në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

27.4. Për gjithë sa sipër arsyetuar, si të ardhurat nga shitja e apartamentit në {***}, në shkurt të vitit 2006, ashtu edhe kursimet e krijuara ndër vite nuk mund të kenë shërbyer si burim për krijimin e pasurisë “apartament banimi” dhe “dy garazhe”, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, në kushtet kur subjekti dhe personi i lidhur kanë rezultuar me mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e tyre.

27.5. Trupit gjykues në Kolegji, nga analiza financiare e kryer lidhur me pasurinë “apartament banimi” dhe “dy garazhe” porositur në bashkëpronësi me z. A. G., ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, sipas kontratës së porosisë, datë 31.12.2005, i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk justifikojnë me të ardhura të ligjshme likuidimin e shumës 15.000 euro më datë 24.03.2006, me burim kursime ndër vite të pajustificuara në vlerën e konstatuar nga Komisioni prej -1.422.785 lekësh dhe pagesën e shumës 34.860 euro në dhjetor 2006, për shkak të mungesës së burimeve financiare të ligjshme, për krijimin e pasurisë “apartament 1+1”, ndodhur në {***}, Kavajë, në vlerën - 853.851 lekë, të ardhurat nga shitja e së cilës kanë shërbyer si burim krijimi për këtë pasuri. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit çmon se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e nenit 33/5, germa “b” të ligjit nr. 84/2016.

*B.2. Pasuria “ndërtesë dy kate + papafingo” dhe “truall” me sipërfaqe 175 m², ndodhur në rrugën “{***}”, nr. {***}, {***}, Tiranë, blerë në vitin 1998*

28. Komisioni, në vendimin objekt shqyrtimi për këtë pasuri, ka arritur në konkluzionet se:

- *Subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer deklaram të plotë të pasurisë së paluajtshme të blerë në rrugën “{***}”, Tiranë, konkretisht, të katit të parë dhe të papafingos së ndërtesës, përfshirë truallin nën ndërtesë dhe oborrin, si dhe sipërfaqet përkatëse; subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar sipërfaqet shtesë në pasurinë nr. {***}, [...]; rezultojnë pasaktësi deklarimi në deklaratën *vetting*, ku subjekti i rivlerësimit vetëm sa e përmend katin [...], por pa specifikuar sipërfaqet përkatëse; [...]; subjekti i rivlerësimit ka mungesë*

*burimesh financiare të ligjshme, në shumën 660.000 lekë [3.150.000 – 2.490.000 lekë (17.000 USD) = 660.000 lekë], për blerjen e shtëpisë së banimit në rrugën “{***}”, Tiranë, në vitin 1998 [3.150.000 lekë pjesa e vet takuese], për arsye se njëri nga burimet financiare, konkretisht, të ardhurat nga shitja e shtëpisë në Rrëshen, janë krijuar në vitin 1999, pra, pas blerjes së shtëpisë në Tiranë, në vitin 1998; subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar deklarin e tij, duke qenë në kushtet e deklarin të rremë, në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë së paluajtshme shtëpi banimi dhe truall të blerë në vitin 1998, në rrugën “{***}”, Tiranë.*

- Komisionit i rezultoi se [...] pas analizës financiare subjekti i rivlerësimit dhe babai tij nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme, për blerjen e banesës në rrugën “{***}”, në shumën totale - 1.410.000 lekë.

28.1. Subjekti i rivlerësimit, kundërshton konkluzionin e Komisionit se ai ka kryer ndërtim pa leje, pasi fakti se i është legalizuar sipërfaqja e ndërtesës prej 151,8 m², pra, 11,8 m² më tepër se sipërfaqja prej 140 m², nuk mund të tregojë apriori se ai e ka bërë këtë shtesë ndërtimi pa leje. Subjekti i rivlerësimit pretendon se thjesht ka cituar dokumentet e prodhuara nga organet e tjera (kontratat e blerjes së truallit, me përshkrimin e shtëpive pa leje mbi to, vërtetimet hipotekore për truallin me përshkrimin e shtëpive, si dhe vërtetimin e pronësisë, me skicat përkatëse të ALUIZNI-t), në këto kushte, nuk ka fshehur dhe nuk ka kryer deklarin të pasaktë. Subjekti e vlerëson plotësisht të pasaktë konkluzionin më sipër të Komisionit, pasi pretendon se nuk kanë bërë asnjë metër katror ndërtim pa leje, apo shtesë anësore të strukturës së murit, nga kati përdhe deri në papafingo dhe, në këtë mënyrë, sipas subjektit nuk ka pasur se çfarë të deklarojë në deklaratat periodike. Në mbështetje të këtij argumenti, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.07.2019, të personit që i ka shitur këtë shtëpi, z. Q. Z., i cili ka deklaruar se deklaron se nuk i është bërë asnjë ndryshim strukturës së jashtme të banesës, si dhe nuk është shtuar askund asnjë metër katror sipërfaqe.

28.2. Sipas subjektit të rivlerësimit në deklarinet periodike vjetore dhe në deklaratën vetting, ka bërë një gabim formal, duke e trajtuar si pasaktësi dhe nxitim faktin se si burim për blerjen e banesës në rrugën “{***}”, bashkë me babain në vitin 1998, përveç të ardhurave nga shitja e shtëpisë në Shkodër, gabimisht ka deklaruar se një pjesë e të ardhurave ka qenë edhe nga shitja e shtëpisë në Mirditë [kur në fakt kjo shtëpi është shitur në vitin 1999]. Pasaktësitë në deklarinet vjetore periodike, por edhe në atë vetting në trajtimet e mëparshme edhe nga Komisioni, por edhe nga Kolegji, nuk janë konsideruar si shkak për marrjen e masës ekstreme ndaj subjektit, kur rezulton se ato janë bërë nga pakujdesia dhe provohet mundësia e subjektit të rivlerësimit dhe e familjes që të ketë pasur vlerat financiare për blerjet e bëra.

28.3. Lidhur me sa pretendon subjekti i rivlerësimit për këtë pasuri, trupi gjykues, pasi analizoi dokumentacionin e administruar, konstaton se:

28.3.1. Në deklaratën e pasurisë vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Me kontratën e shitblerjes, datë 27.06.1998, midis shitësit Q. Z. dhe meje Gjovalin Përnoca si blerës, është bërë kontrata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., me të cilën kam blerë pre tij (në rrugën “{***}”, nr. {***}), oborrin truall 105 m² dhe 70 m² truall ndërtesë, (pra, gjithsej 175 m² truall) dhe banesën në katin e {***} me 2+1, etj. dhe kati i dytë (i tretë), 1 dhomë, me çmimin 3.150.000 lekë, të cilat do të jepeshin më datë 01.08.1998. Me deklaratën noteriale, datë 04.08.1998, del se nga unë është likuiduar plotësisht vlera e saj (katin e parë të po kësaj ndërtesë, me 2+1, etj. dhe oborrin truall prej 105 m² dhe 70 m² truall ndërtesë, pra, gjithsej 175 m² truall, më datë 26.06.1998 e ka blerë babai im B. P., për 1.950.000 lekë). Me certifikatën e pronësisë nr. {***}, datë 26.05.2015, më është regjistruar pasuria prej 175 m²

truall (me certifikatën nr. {***}, datë 26.05.2015, i është regjistruar pasuria prej 175 m² truall edhe babait). Me lejen e legalizimit, datë 20.09.2016, të ALUIZNI-t, është lejuar legalizimi i objektit dykatësh + papafingo për Gjovalin Përnoca dhe B. P.. Me certifikatën e pronësisë, nr. {***}, datë 23.12.2016, është regjistruar pasuria prej 175 m² nr. {***}(vetëm shtëpitë, pa truall), për Gjovalin dhe B. P. me nga ½ pjesë [...].

Burimi i krijimit është nga shitjet e shtëpive në Shkodër e në Rrëshen. Vlera e pasurisë me shifra dhe fjalë është deklaruar “3.150.000 (tre milionë e njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, 50% me bashkëshorten”.

Në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Shtëpi banimi, 2+1, vlera 3.500.000 lekë, burimi e blerë në vitin 1998, nga shitja e shtëpisë së mëparshme të privatizuar dhe kursimet nga pagat”.

28.3.2. Pasuria objekt shqyrtimi, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, është përfituar me kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.06.1998, nëpërmjet të cilës shitësi Q. Z. i shet blerësit Gjovalin Përnoca truallin oborr prej 105 m² dhe 70 m² truall ndërtese dhe katin e parë (dytë) të përbërë prej dy dhoma një kuzhinë, aneks, korridor e verandë dhe katin e dytë (tretë) të përbërë prej një dhome me dimensione 6 m x 5 m, kundrejt çmimit 3.150.000 lekë, i cili është likuiduar dhe vërtetuar me deklaratën noteriale, datë 01.08.1998. Me certifikatën e pronësisë, nr. {***}, datë 26.05.2015, është regjistruar pasuria prej 175 m² truall në emër të Gjovalin Përnoca.

28.3.3. Me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.06.1998, shitësi Q. Z. i shet blerësit B. P. ½ pjesë të truallit që zë ndërtesa të barabartë me 70 m² (shtatëdhjetë metra katrorë), sipërfaqen 105 m², si dhe katin përdhes të përbërë me dy dhoma e një kuzhinë, korridor, duke mbetur në bashkëpronësi me katin tjetër të ndërtesës, për çmimin 1.950.000 lekë. Me certifikatën e pronësisë, nr. {***}, datë 26.05.2015, është regjistruar pasuria prej 175 m² truall në emër të B. P..

28.3.4. Sipas vërtetimit hipotekor nr. {***}, datë 30.06.1998, si dhe kartelë pasurie e paluajtshme¹⁷ figuron e regjistruar në emër të Gjovalin Përnocës, pasuria nr. {***}, e ndodhur në zonën kadastrale 8120, me sipërfaqe 175 m², me përshkrimin “truall oborri prej 105 m² dhe 70 m² truall nën ndërtesë dhe katin e parë (i dytë) i përbërë prej dy dhoma një kuzhinë, aneks, korridor e verandë dhe katin e dytë (tretë) të përbërë prej një dhome me dimensione 6 m x 5 m”. Në rubrikën “Komente nga regjistruesi” gjendet shënimi: “ky vërtetim është i vlefshëm për truallin”. Konstatohet se në momentin e hartimit të kontratës së shitjes, megjithëse është përmendur dhe ekzistenca e një shtëpie banimi, ajo ka qenë e peregjistruar në regjistrat kadastralë të kohës.

28.3.5. Në fashikullin gjyqësor gjenden të administruar 5 (pesë) formularë të vetëdeklarimit të objektit në legalizim të nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit dhe babai i tij, që i përkasin të njëjtit objekt, por me data të ndryshme aplikimi gjatë vitit 2006 dhe ku vetëdeklarohet si vit ndërtimi i objektit viti 1979. Bazuar në lejen e legalizimit nr. {***} prot., datë 29.09.2016, për objektin “Godinë banimi 2 kate + papafingo”, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 335.3 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 151.8 m² me dy kate mbi tokë në emër të B. dhe Gjovalin Përnoca, ZVRPP-ja Tiranë ka lëshuar certifikatën e pronësisë, datë 23.12.2016, në emër të Gjovalin Përnoca dhe B. P., për sipërfaqen e ndërtesës 151.80 m², me nr. pasurie {***}, me pjesë takuese ½.

¹⁷ Përcjellë Komisionit me praktikë legalizimi ndërtese për shtetasin Gjovalin Përnoca dhe personat e lidhur me të, nga Drejtoria Vendore ASHK, Tirana Veri, me shkresë nr. {***} prot., datë 05.06.2019, në përgjigje të kërkesës për informacion të Komisionit, me shkresën nr. {***} prot., datë 27.05.2019.

28.3.6. Bashkëlidhur ankimit, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Kolegj një kërkesë ku, ndër të tjera, pretendon se Leja e Legalizimit, nr. {***}, datë 29.09.2016, është e pasaktë, pasi sipërfaqja totale e ndërtimit e shënuar në të është 32.7 m² më tepër se sa ka blerë në kontratën e vitit 1998. Gjithashtu, certifikata e pronësisë, nr. {***}, datë 23.12.2016, lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë është e pasaktë, pasi subjekti i rivlerësimit rezulton bashkëpronar në ½ pjesë të sipërfaqes së banimit prej 151.80 m², kur në fakt subjekti i rivlerësimit pretendon se ka në pronësi, përkatësisht, babai i tij katin përdhe prej 140 m², vetë ai katin e parë prej 140 m² dhe papafingon 30 m². Për këtë subjekti i rivlerësimit, më datë 17.12.2019, i ka kërkuar AShK, Drejtorisë Vendore, Tiranë, korrigjimin e certifikatës së pronësisë së sipërcituar. Në përgjigjen me shkrim, pa numër protokollit dhe pa datë, por e firmosur dhe vulosur me urdhër delegimi nga zv/drejtor znj. S. M., AshK-ja sqaron subjektin, se: “[...], leja e legalizimit është lëshuar për objektin ‘godinë banimi 2(dy) kate + papafingo’, duke e trajtuar tërësisht si objekt të ri ndërtimit, ndërkohë, që ju kërkoni korrigjimet përkatëse, duke iu referuar kontratës së shitjes me anë të së cilës keni fituar pronësinë mbi pasurinë nr. {***} dhe {***}, për të cilat jeni pajisur me certifikatë pronësie vetëm për truallin”.

28.3.7. të dokumentacionit tekniko-ligjor, sipas parashikimeve të nenit 27¹⁸ të ligjit nr. 8482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”. Gjithashtu, sipas procesverbalit të verifikimit në terren, datë 02.05.2016, tre specialistëve të Drejtorisë Vendore të ALUIZNI-t Tiranë u ka rezultuar se [...], ndërtimi pa leje që shfrytëzohet për banim është 358,6 m², [...]. Pra, subjekti i rivlerësimit ka qenë në dijeni të plotë të sipërfaqes që do t’i legalizohej. Subjekti i rivlerësimit, edhe pasi është pajisur me Lejen e Legalizimit nr. {***}, më datë 29.09.2016, si dhe certifikatën e pronësisë nr. {***}, më datë 23.12.2016, nuk konstatohet të ketë ankimuar në rrugë administrative apo gjyqësore, pretendimet të cilat i ngre vetëm pas dhënies së vendimit të Komisionit, ku janë konstatuar sipërfaqet shtesë, megjithëse ka disponuar dokumentacionin e mësipërm, prej vitit 2016.

28.3.8. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit, se këto diferenca janë kryesisht gabime në matje ndër vite duke mos njohur nocionet mbi sipërfaqet e matshme si sipërfaqe banimi, sipërfaqe ndërtimi dhe sipërfaqe ndihmëse, trupi gjykues i Kolegjit i vlerëson të pabazuara, pasi referuar jo vetëm deklaratës noteriale¹⁹ nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.05.2016, por dhe dokumentacionit të përcjellë nga ALUIZNI, rezulton që subjekti i rivlerësimit ka sipërfaqe më të madhe ndërtimore nga ajo që pretendon se ka blerë, konkretisht, për katin e dytë 11 m² më tepër [151 m²-140 m²] dhe për katin e tretë papafingo 21,7 m² më tepër [51,7 m² – 30 m²].

¹⁸ Në nenin 27 të ligjit nr. 8482, datë 03.04.2006, citohet: “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e ndërtimit informal përfshin: a) gen-planin e objektit në shkallën 1:500; b) planimetrinë e çdo kati të objektit dhe sipërfaqet në m², që do të legalizohen në shkallë 1:100; c) certifikatën e përbërjes familjare; ç) vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjisllacionit në fuqi; d) vërtetimin ose certifikatën e pronësisë së parcelës ndërtimore ose çdo akt tjetër ligjor për fitimin e pronësisë, nëse subjekti i disponon këto. i njëjti dokumentacion kërkohet dhe për ndërtimin me leje, apartamentin dhe njësinë e shërbimit, në rastin e shtesave pa leje të realizuara në këto ndërtime; dh) deklaratën personale, që merr përsipër përgjegjësinë për çdo pasojë, që mund të rrjedhë nga shkaqe natyrore dhe/ose nga përdorimi i banesës. Sipas këtij ligji, shteti nuk është përgjegjës për kompensimin ose dëmshpërblim në raste fatkeqësish, si pasojë e faktorëve, që ndikojnë në qëndrueshmërinë e objektit; e) akt-ekspertizë nga një ekspert ose ent i licencuar për qëndrueshmërinë konstruktive të objektit, për ndërtimet me lartësi mbi 4 kate; ë) marrëveshjen noteriale për pjesët takuese, sipas pikës 2 të nenit 30 të këtij ligji, nëse ajo realizohet. Poseduesi i ndërtimit pa leje, për dokumentacionin e mësipërm, paguan tarifën e shërbimit.

¹⁹ Në deklaratën noteriale nr. {***} rep, nr. {***} kol., datë 11.05.2016, subjekti i rivlerësimit dhe babai i tij, deklarojnë: Për efekt saktësimi për sa më sipër deklarojmë se ndërtimi i banesës tonë dykatëshe dhe me papafingo, siç është përshkruar, matur, e fotografuar dhe në gjendjen që është sot është bërë dhe transformuar pjesë-pjesë nga ne në gjendjen që është dhe aktualisht, por pas vitit 1998 e në vijim.

Subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e mosdeklarimit të saktë të sipërfaqes së objektit në deklaratën e pasurisë *vetting*.

28.3.9. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, duke e konsideruar si pasaktësi deklarimin e tij në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim 2003, të vlerës së këtij objekti, 3.500.000 lekë, në një kohë që në kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.06.1998, është përcaktuar çmimi prej 3.150.000 lekësh, trupi gjykues çmon se deklarimi i pasaktë, i paplotë dhe/apo i pavërtetë në deklaratat e interesave privatë periodikë, lidhet drejtpërdrejt me përgjegjësinë që kanë subjektet deklaruuese për të përmbushur detyrimet ligjore të parashikuara nga ligji nr. 9049/2003.

28.3.10. Trupi gjykues i Kolegjit çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i gatshëm për të dhënë informacion të saktë, duke vështirësuar në këtë mënyrë punën e Kolegjit në kundërshtim me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, për llogaritjen dhe përcaktimin e saktë të vlerës së këtij investimidhe për sipërfaqen e kësaj pasurie, duke kryer pasaktësi në deklarim, sipas nenit 33/5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

28.4. Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë në rrugën “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, deklaroi:

- *Të ardhurat nga shitjet e shtëpive në Shkodër dhe Rrëshen. Konkretisht, me kontratën e datës 25.09.1996, midis Entit të Banesave Shkodër dhe meje, është lidhur kontrata paraprake për blerjen e banesës 2+1 etj., ku kam paguar 35.000 lekë. Më datë 06.11.1997, kemi bërë kontratë shitje përfundimtare, me vlerën 1.,248.167 lekë ose 8.603 USD, sasi të cilën nisur nga fakti që isha në punë prej vitit 1982, pra, për 15 vjet, pothuajse i kam pasur. Vetëm në vitin 1993, nga shërbimi [maj-qershor] në ShBA [programi i USA], jam kthyer me 2.400 USD të kursyera nga dieta ditore.*
- *Me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.11.1997, ia kam shitur këtë shtëpi nd/jes italiane, “MEDISH”, për vlerën 30.000USD , pra, 21.397 USD ose 3,134,660 lekë më shumë se blerja [pasi kursi ishte me 146.5].*
- *Nga këto dollarë, 13.000 janë ruajtur deri në fund të vitit 2004 dhe janë përdorur, [...]. Ndërsa pjesa tjetër e parave [30,000 USD – 13,000 USD], prej 17,000 USD apo 2.490.000 lekësh, kanë shërbyer për blerjen e kësaj shtëpie.*
- *Blerja e kësaj shtëpie është plotësuar edhe nga gjysma e parave të përfituara nga shitja e shtëpisë në Rrëshen. Konkretisht, me kontratën e privatizimit, datë 20.12.1993, me Komunale Banesa Mirditë, kam blerë një banesë 2+1 me çmim 28.214 lekë, të cilën e kam me bashkëshorten dhe dy prindërit [në një certifikatë familjare], me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.06.1999, të cilën e kemi shitur për 1.500.000 lekë, nga të cilat ½, gjysma ishte e jona. Pra, 2.490.000 lekë + 750.000 lekë = 3.240.000 lekë, pra, më tepër se vlera e shtëpisë e trullit [në rrugën “{***}, nr. {***}, Tiranë]. Vlera e deklaruar: “28.214 lekë”; pjesa takuese: “100%”.*
- *Në deklaratë e personit që mbart detyrimin për deklarim, 2003, subjekti deklaroi, “shtëpi banimi, 2+1, vlera 3.500.000 lekë, pjesa takuese: 50%”, adresë: rruga “{***}”, [...], e blerë në vitin 1998, me burim: nga shitja e shtëpisë së mëparshme të privatizuar dhe kursimet nga pagat.*

28.5. Trupi gjykues në Kolegji, nisur nga sa deklaroi subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, se si burim për krijimin e kësaj pasurie kanë shërbyer *shitja e shtëpive në Rrëshen dhe Shkodër*, analizoi dokumentacionin justifikues të administruar për këto pasuri, nga ku konstatoi:

*Për apartamentin në Rrëshen, të pretenduar si burim krijimi për banesën në rrugën “{***}”, Tiranë*

28.5.1. Bashkëlidhur dokumentacionit përcjellë Komisionit, me shkresën nr. {***} prot., datë 21.05.2019, nga EKB-ja, Drejtoria Ekonomike, rezulton kontratë për privatizim banese, datë 20.12.1993, mes Ndërmarrjes Komunale Banesa dhe qiramarrësit Gj. P., për privatizimin e banesës nr. 3, [...], kundrejt pagesës së menjëhershme, në shumën 28.214 lekë [likuiduar me mandatarkëtimin nr. {***}, datë 20.12.1993]. Sa sipër e vërtetuar me vërtetim nr. {***} regj., datë 21.12.1993.

28.5.2. Me kontratë shitblerje “Shitblerje ap. banimi në Rrëshen”, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.06.1999, shitësit P. P., A., Gjovalin dhe B. P. i shesin blerësit Gj. K., apartament banimi në Rrëshen, me nr. {***}, vol. {***}, f. {***}, pall. nr. {***}, shk. {***}, kati {***}, i përbërë nga dy dhoma e një kuzhinë, me sipërfaqe 108,9 m², kundrejt çmimit 1.500.000 lekë.

28.5.3. Trupi gjykues, nga sa sipër, konstaton se kjo shtëpi, sipas kontratës shitblerje apartament banimi në Rrëshen, nr. {***} rep., nr. {***} kol., është shitur më datë 07.06.1999, ndërkohë që banesa në rrugën “{***}”, nr. {***}, Tiranë, është likuiduar më datë 26.06.1998, pagesa e fundit për këtë apartament është bërë më datë 04.08.1998. Për rrjedhojë, shuma 750.000 lekë, nga të ardhurat nga shitja e banesës në Rrëshen në vitin 1999, nuk mund të kenë shërbyer si burim krijimi për banesë në rrugën “{***}”, Tiranë, të blerë në vitin 1998, duke e vendosur subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklaramit të rremë, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016.

*Për apartamentin në Shkodër, të pretenduar si burim krijimi për banesën në rrugën “{***}”, Tiranë*

28.6. Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme, për blerjen e apartamentit të banimit në Shkodër, në shumën - 544.620 lekë [...].

28.7. Lidhur me këtë konstatim të Komisionit, subjekti i rivlerësimit pretendon:

- se ka deklaruar si burim të kësaj pasurie, si në deklaratën e pasurisë vetting, ashtu edhe në deklaratë e interesave privatë 2003: (1) kursimet e 15 viteve punë; si dhe (2) shumën prej 2.400 USD të kursyer nga dietat e përfituara për periudhën maj-qershor 1993, nga shërbimi në ShBA, për të cilat subjekti pretendon të ketë sjellë tri deklaratë nga tri kolegë, [...], me të cilët ka qenë në të njëjtin shërbim;
- se deri në vitin 1996 ka jetuar me prindërit dhe shpenzimet jetike kanë qenë edhe më të vogla. Për efekt të llogaritjes së tyre, duhet të merret si raport 30% ndaj të ardhurave, ashtu si rezultojnë edhe nga minimumi jetik, sipas ILDKPKI-së në raport me të ardhurat familjare nga paga për periudhën 2003-2008, [...];
- se i ka munguar ndonjë sasi e vogël, [deri në 200,000 lekë të reja], të cilat ia ka marrë vëllait, Viktorit, që i kishte të lira paratë e shitjes së shtëpisë së Kukësit, në sasinë prej 1.050.000 lekësh, që prej datës 30.08.1995;
- për pagat e bashkëshortes, për të cilat nuk disponohet bordero për periudhën 1988 -1993, subjekti i rivlerësimit pretendon të ketë siguruar si provë Akt-Verifikim të Vjetërsisë në Punë para vitit 1994, me nr. {***} prot., datë 24.07.2019, të Arkivës së DRSSh-së Lezhë. Meqenëse për këtë periudhë punësimi, nuk posedohen dokumente për të ardhurat e përfituara, për efekt llogaritje, subjekti kërkon të merren në konsideratë pagat referuese të publikuara në faqen e ISSh-së para vitit 1994, sipas VKM-së nr. 561, datë 12.08.2005. Në mungesë të

dokumentacionit, për të kryer një analizë sa më afër realitetit, për periudhën mars 1988-dhjetor 1993, *subjekti ka llogaritur pagën e bashkëshortes sa 70% të pagës së tij, [76.500 lekë x 70%];* - nga analiza financiare e kryer i rezultoi që për periudhën 1982-1997, të ketë pasur mundësi për të kursyer me të ardhura të ligjshme, shumën 923.587 lekë. Nëse kësaj shume, i shtojmë dietat e përfituara, për periudhën maj-qershor 1993, në shumën 2.400 USD apo 345.240 lekë, [këmbyer me kursin e datës 06.11.1997, 1USD=143.85 Lekë], si dhe dietat e llogaritura në vlerën 90.000 lekë, subjektit i rezultoi se ka pasur mundësi kursimi në shumën 1.358.847 lekë, duke përballuar pagesën për apartamentin në Shkodër, në vlerën 1.248.167 lekë dhe diferenca prej 10.680 lekësh ka shërbyer si kontribut për blerjen e apartamentit në Rrëshen. Duke marrë parasysh edhe huan e marrë nga vëllai, tregohet qartë se kam pasur mundësi financiare të ligjshme për të blerë apartamentin në Shkodër.

28.8. Për pretendimet sa më sipër, trupi gjykues në Kolegj analizoi dokumentacionin dhe verifikoi mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për krijimin e kësaj pasurie.

28.8.1. Sipas kontratë e përkohshme për shitje apartamenti banimi, datë 25.09.1996, të EKB-së, rezultoi se shitësi Gj. P. i shet blerësit Gjovalin Përnoca, apartament banimi 2+1, me sipërfaqe 69.20 m², i cili ndodhet në rrugën “{***}”, [lagjja 4], Shkodër, nga firma ndërtuese “B.B.P.P”. Shitja mbështet në VKM-në nr. 528, datë 17.10.1994, “Për mënyrën e ndarjes së apartamenteve të ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave”.

28.8.2. Me kontratë shitje apartamenti banimi me pagesë të menjëhershme, [formulari 12/1], datë 6.11.1997, ndërmjet EKB-së Shkodër, në cilësinë e shitësit dhe blerësit Gjovalin Përnoca, me objekt apartamentin e banimit nr. {***}, ndodhur në katin e {***}, shkalla e {***}, banesa nr. 32, rruga “{***}”, lagjja “{***}”, qyteti Shkodër, me sipërfaqe shfrytëzimi 78,5 m² [...], regjistruar në Zyrën e Hipotekës Shkodër, me nr. {***}, datë 27.11.1996.

28.8.3. Me akt shitblerje prone/pasurie të paluajtshme “apartament banimi”, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.11.1997, shitësit Gjovalin dhe A. P. i shesin blerësit “MA.DI.Sh”, me NIPT {***}, pasurinë apartament më sipër, përfutur me kontratë shitje apartamenti banimi me pagesë të menjëhershme, datë 6.11.1997, kundrejt vlerës 30.000 USD, likuiduar tërësisht me para në dorë [...].

28.8.4. Bazuar në të dhënat e dokumentacionit e mësipërm, me qëllim verifikimin e mundësisë financiare, u krye analiza financiare në Kolegj, nga ku trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e apartamentit në Shkodër, më datë 06.11.1997, në vlerën negative - 627.782 lekë. Gjithashtu, u krye analiza edhe duke marrë në konsideratë në analizë pretendimet e subjektit të rivlerësimit në ankim lidhur me të ardhurat nga pagat e bashkëshortes, huan në shumën 200.000 lekë nga i vëllai, si dhe shpenzimet jetike në masën 30% të të ardhurave nga pagat, nga ku subjekti dhe personi i lidhur rezultoi përsëri me diferencë negative, megjithëse reduktohet në vlerën - 152.794 lekë. Në të dy metodat e llogaritjes nuk janë konsideruar në të ardhura të ligjshme dietat e përfituara, për periudhën maj-qershor 1993, në shumën 2.400 USD apo 345.240 lekë, [këmbyer me kursin e datës 06.11.1997, 1USD=143.85 Lekë], si dhe dietat e llogaritura në vlerën 90.000 lekë, për një periudhë 6-mujore, referuar në jurisprudencën e Kolegjit²⁰, duke vlerësuar se dieta është një e ardhur, e cila referuar qëllimit për të cilin jepet (për shpenzime jetike thelbësore), nuk mund të kursehet.

28.9. Në konkluzion të gjithë sa më sipër arsyetuar, ndodhur në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për blerjen e

²⁰ Vendimi nr. 7, datë 05.04.2019 (JR) dhe vendimi nr. 9, datë 22.05.2019 (JR), i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

shtëpisë në Shkodër, në vlerën negative - 627,782 lekë, si dhe të pasaktësive në deklaram në deklaratën e pasurisë *vetting* se të ardhurat nga shitja e shtëpisë në Rrëshen kanë shërbyer si burim për krijimin e kësaj pasurie - 750.000 lekë, shoqëruar me mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e kursimeve ndër vite, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklaramit të pasaktë të pasurisë në deklaratën e pasurisë *vetting*, të deklaramit të rremë dhe të pamjaftueshmërisë financiare në vlerën - 1.377.782 lekë, për pasurinë “ndërtesë dy kate + papafingo” dhe “truall” me sipërfaqe 175 m², ndodhur në rrugën “{***}”, nr. {***}, {***}, Tiranë, të blerë në vitin 1998, në kuptim të nenit 33/5, geramat “a”, “b” dhe “ç” e ligjit nr. 84/2016.

B.3. Lidhur me depozitën në shumën 3.200.000 lekë e depozituar në bankë, më datë 20.09.2002, në llogari të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, si dhe depozita në shumën 35.000 USD, më datë 31.07.2003, në Intesa Sanpaolo Bank, ShA

29. Komisioni në vendim, lidhur me depozitat, ka konkluduar se:

- *Komisioni krijoi bindjen se shuma prej 3.200.000 lekësh, e depozituar në emër të znj. A. P., në datën 20.9.2009, në Bankën Amerikane, është pasuri në pronësi të personit të lidhur me subjektin, [...], duke e konsideruar të rremë deklaramin e subjektit të rivlerësimit se kjo pasuri është e znj. M. V.;*
- *nga analiza financiare, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, kanë [...], mungesë burimesh të ligjshme në shumën 1.878.236 lekë, për krijimin e depozitës në shumën 3.200.000 lekë, në emër të bashkëshortes;*
- *subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë deklaruar depozitën prej 35.000 USD, në emër të bashkëshortes A. P., në deklaratën e pasurisë të vitit 2003 dhe në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2004;*
- *subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk provuan me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të krijimit të shumës prej 35.000 USD, të pretenduar si pasuri e znj. M. V. dhe bashkëshortit të saj, si dhe transferimin e saj në Shqipëri;*
- *Komisioni, duke marrë shkas nga dokumentacioni dhe deklarimet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit, krijoi bindjen se depozita bankare prej 35.000 USD është pasuri e subjektit dhe e personit të lidhur me të, sikurse rezulton nga informacioni bankar dhe jo e shtetases M. V. dhe bashkëshortit të saj, duke arritur në konkluzionin se kemi të bëjmë me një pasuri të fshehur nga subjekti i rivlerësimit dhe e personit të lidhur me të.*

29.1. Subjekti i rivlerësimit, në ankim dhe parashtrime i vlerëson jo të drejta dhe reale konkluzionet e mësipërme të Komisionit, pasi konstatimet e tij janë krejt arbitrare, në kundërshtim me provat e depozituara nga subjekti në Komision dhe ato të administruara prej tij, për këto arsye:

29.1.1. Siç ka shpjeguar edhe në përgjigjet e pyetësorëve të Komisionit, depozitimi në shumën 3.200.000 lekë në Bankën Amerikane, [aktualisht Intesa Sanpaolo Bank, ShA], më datë 20.09.2002, është bërë pasi në shtator të vitit 2002, së bashku me bashkëshorten kanë qenë vizitorë në Londër dhe mbesa M. V. i ka dhënë bashkëshortes për t'i sjellë në Shqipëri dhe për t'i ruajtur, sasinë prej 8.000 pound, si dhe është porositur të pranojë nga familjarët e tjerë në Shqipëri edhe disa para të tjera, t'ia ruante të gjitha bashkë. Sipas subjektit, [...], këto para janë sjellë në shtator 2002 nga bashkëshortja dhe subjekti, pa pasur nevojë të bënim deklarime në kufirin anglez apo shqiptar, pasi sasia ishte poshtë limitit të deklarueshëm. Këtë sasi, sipas porosisë së mbesës M. V. ia ka dhënë vëllait të bashkëshortes P. N., i cili i ka konvertuar në dollarë, i ka bashkuar me para të tjera, të cilat me raste mbesa i kishte dërguar në Shqipëri gjatë viteve 2001-2002 me familjarë të besuar, [...], për t'ia ruajtur pasi Preng Nikollaj u

sëmur rëndë. [...], bashkëshortja i ka depozituar në bankë derisa janë kërkuar prej pronarëve të tyre.

29.1.2. Duke qenë se M. V. kishte vendosur të zgjidhte martesën me bashkëshortin kanë bërë deklaratë të pjesëtimit vullnetar të pasurisë së luajtshme, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.07.2004, ku deklarojnë se: *“I. gjatë jetës së tyre bashkëshortore, ata kanë krijuar një shumë të hollash prej 22.700 USD dhe 5.900 GBP, nga puna dhe kursimet”, [...].* Deklarimi mësipër provohet edhe me: (1) deklaratë noteriale nr. {***} rep., datë 15.12.2004, të znj. M. V.; (2) deklaratë e pjesëtimit vullnetar nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.07.2004; (3) procesverbal i datës 15.12.2004, i verifikimit nga ILDKPKI-ja; si dhe (4) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.04.2019, të znj. M. V. [hartuar nga i njëjti noter].

29.1.3. Sa i përket burimit të ligjshëm të krijimit të këtyre shumave, mbesa e bashkëshortes, në deklaratë e pjesëtimit vullnetar, deklaronte se *gjatë jetës bashkëshortore kanë krijuar një shumë të hollash “[...], nga puna dhe kursimet”.* Në deklaratë noteriale të datës 17.04.2019, znj. M. V. ka deklaruar se *ajo dhe bashkëshorti kanë punuar që nga viti 1998 deri më 2004, në punë të rënda në Londër, [...]. Kjo është e vërteta e vetme.* Nëse do të kishte qëllim të fshihte pasuri, subjekti nuk do të kishte pasojë edhe sikur të deklaronte që këto vlera ishin të tyre në vitin 2004, pasi kishte 21 vjet punë në drejtësi dhe depozitat bankare ishin plotësisht të justifikuara.

29.1.4. Subjekti kundërshton konstatimin e Komisionit në vendimin e ankimuar se *ka mospërputhje të deklarimeve të subjektit, në lidhje me shumën e depozituar nga bashkëshortja e tij për llogari të shtetases M. V. [3.200.000 lekë apo 35.000 USD] dhe kryerjes së veprimeve paraprake përgatitore për depozitimin e kësaj shume [...], si dhe konkluzionin e Komisionit se pretendimi i subjektit për shumën prej 3.200.000 lekësh depozituar në emër të shtetases A. P., nuk i përket asaj, por mbesës së saj [...], nuk është bindës dhe [...], është i pa mbështetur në prova,* pasi për vlerat monetare: (i) është vepruar në rrethana mirëbesimi; (ii) transaksioni i përket një periudhe të largët kohe dhe këto sjellje me lekun dhe mirëbesimi i familjarëve kanë qenë më se normale në shoqërinë shqiptare; (iii) kërkimi i të dhënave, fakteve dhe provave për një periudhë të hershme kohore, përbën cenim të parimit kushtetues të “sigurisë juridike”; (iv) në kushtet, kur është provuar se vlerat monetare janë sjellë nga mbesa e gruas, janë konvertuar nga të afërmit e saj, janë depozituar për të dhe janë marrë përsëri prej saj, *“pasaktësitë” e thënieve, kur vlerat kanë qenë thujse ekuivalente, nuk mund të kenë rëndësi vendimtare, aq më pak, të bëjnë që subjekti të konsiderohet pronar i këtyre parave.*

29.1.5. Është e vërtetë që kjo depozitë nuk është deklaruar në deklaratën e pasurisë të vitit 2003 dhe as atë të vitit 2004, [kur kjo depozitë është mbyllur], *pasi nuk ishte pasuri e familjes, por e mbesës së gruas. Meqë ishte viti i parë i deklarimit, nuk kishte dijeni për detyrimin për deklarim të çdo leku qoftë edhe i të tjerëve. [...], këtë problem e ka konstatuar ILDKPKI-ja që në vitin 2004, ka bërë deklaratë noteriale mbesa e bashkëshortes, ku shpjegon se këto kursime janë të familjes së saj, se ia kishte lënë në ruajtje bashkëshortes që në vitin 2002 dhe se i ka marrë dhe ndarë me bashkëshortin e saj, etj. Meqë ILDKPKI-ja e ka verifikuar që në dhjetor të vitit 2004, duke mbajtur procesverbal, ku u sqarua gjithçka, subjekti ka menduar se kjo çështje ishte tashmë e sqaruar plotësisht, pra e tejkaluar, prandaj edhe nuk e ka deklaruar më. Prej vitit 2004, që subjekti ka sqaruar ILDKPKI-në ata nuk kanë pasur asnjë vërejtje, por, çuditërisht, megjithëse i kontrolluar rregullisht, në vitin 2019 mësoi se ILDKPKI-ja ka vërejtje për këto para.*

29.1.6. Lidhur me konstatimin e Komisionit se ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor nga znj. M. V. dhe ish-bashkëshorti i saj, për krijimin e shumës 35.000 USD ndër vite, subjekti ngre pretendimin se *nuk ka barrën e provës për të provuar origjinën e parave të tyre, pasi ato*

ishin në ruajtje, situatë të cilën e kanë sqaruar mbesa dhe ish-bashkëshorti në deklaratat noteriale të vitit 2004 dhe 2019. [...], ky fakt është pohuar prej tyre në deklaratë noteriale të datës 06.07.2004, [pa praninë e subjektit dhe personit të lidhur, hallës, si dhe pa u pyetur akoma nga ILDKPKI-ja], kur kanë bërë pjesëtimin vullnetar të parave. Subjekti pretendon se nuk janë persona të lidhur me ta, pasi në kuptim të ligjit as nuk i kanë familje, as nuk kanë pasur marrëdhënie interesi dhe/

29.2.1. e nivelit të dytë, ka rezultuar që në Bankën Amerikane të ketë pasur një llogari në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, me balancë 35.071,46 USD, në fund të vitit 2003. Në përgjigje të ILDKPKI-së, subjekti i rivlerësimit ka pohuar se kjo depozitë nuk i përket familjes së tij, por është e shtetasës M. N. V., e cila ka banuar prej pesë vjetësh në Angli dhe prej qershorit të vitit 2004 është kthyer në Shqipëri. Lidhur me këtë fakt, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale²¹ nr. {***} rep., datë 15.12.2004, të shtetasës M. V., si dhe deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.04.2019, ku deklaruesja M. M. (me mbiemër nga martesë e parë V.) ka ripërsëritur thëniet e saj në deklaratën noteriale të vitit 2004, duke rikonfirmuar faktin se shuma prej 35.000 USD e depozituar prej znj. A. P., iu la asaj në ruajtje.

29.2.2. Trupi gjykues çmon se pavarësisht pretendimeve të subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, por edhe në Kolegj, si dhe përpjekjeve të tij për të justifikuar faktin se depozita në shumën 3.200.000 lekë, e konvertuar në 35.000 USD, nuk i përket bashkëshortes së tij, A. P., por mbesës së saj, nuk u provua me dokumente dërgimi i shumave të pretenduara të transferuara nga Anglia për t'i ruajtur ato, duke mbetur ky pretendim vetëm në kuadër deklarativ, i paprovuar dhe i pavërtetuar me dokumentacion justifikues ligjor, sipas kërkesave nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

29.2.3. Trupi gjykues, pasi analizoi dokumentacionin e dosjes gjyqësore për këto depozita, si dhe pretendimet e subjektit në ankim, i rezultoi se ato janë jo bindëse, të pabazuara e kontradiktore, pasi si subjekti, ashtu edhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar në deklaratën e vitit 2003 destinacionin e depozitës 3.200.000 lekë të tërhequr më 20.03.2003, si dhe depozitën në dollarë amerikanë me balancë 35.071,46 USD në fund të vitit 2003 dhe me balancë 12.006,36 USD, në fund të vitit 2004. Në kushtet kur nuk u provua nga subjekti i rivlerësimit me dokumentacion justifikues dhënia e shumës 8.000 GBP bashkëshortes së subjektit nga mbesa, si dhe dhënia apo transportimi i diferencës, që e krijon shumën 35.000 USD, anëtarëve të tjerë të familjes, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se nuk i ka deklaruar, pasi nuk ishin të bashkëshortes, nuk qëndron. Mosdeklarimi në deklaratat periodike vjetore të shumës 3.200.000 lekë të tërhequr në mars 2003 dhe gjendjen e depozitës në shumën 35.000 USD në fund të vitit 2003 dhe 2004, bie në kundërshtim me detyrimet e tij si subjekt deklarues, parashikuar në nenin 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003.

²¹ Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., datë 15.12.2004, shtetasja M. V. deklaron: “Në shtator të vitit 2002 kanë qenë vizitor në Angli halla ime së bashku me bashkëshortin e saj, respektivisht A. e Gjovalin Përnoca. Në këtë rast, kur ata u larguan u kemi dhënë kursimet tona nga puna prej rreth pesë vjetësh në Angli. Unë kam qenë atje së bashku me bashkëshortin tim A. V.. Këtë shumë prej 35.000 USD (tridhjetë e pesë mijë) halla ime e ka depozituar pranë Bankës Amerikane me konto nr. {***}, më datë 20.02.2002, mbi kërkesën tonë kjo shumë është tërhequr në janar të vitit 2004. Meqenëse unë deri në qershor të këtij viti kam qenë me banim dhe punë në Angli këto vlera ruheshin për llogarinë tonë pranë bankës. Në qershor të vitit 2004 jemi kthyer në Shqipëri dhe e gjithë vlera e depozituar na është dhënë në dorë, mua dhe bashkëshortit tim. Sikurse bëhet e qartë nga akti noterial i datës 06.07.2004, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., me notere T. M., pjesa që na kish mbetur në këtë kohë është pjesëtuar vullnetarisht mes meje dhe bashkëshortit tim”.

29.2.4. Pavarësisht se subjekti i rivlerësimit paraqiti deklarata noteriale të vitit 2004 dhe 2019, të deklaruara nga M. V., për të vërtetuar pronësinë e saj mbi shumën 35.000 USD, trupit gjykues i Kolegjit, pas analizimit të tyre, çmon se për sa kohë depozita e sipërcituar provohet të ketë qenë në emër të bashkëshortes së subjektit A. P., subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin ligjor ta deklaronte këtë depozitë në deklaratat periodike të viteve 2003 e 2004, si dhe të justifikonte burimin e ligjshëm të shumës 35.000 USD, sipas kërkesave të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

29.2.5. Nga analiza financiare e kryer në Kolegji, për të provuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të krijuar depozitën 3.200.000 lekë, më datë 29.07.2002, trupit gjykues i rezultoi që subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj depozite, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

29.2. Në përfundim të sa sipër arsyetuar, trupit gjykues i Kolegjit e vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit se ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e depozitës në shumën 3.200.000 lekë të depozituar në bankë, më datë 20.09.2002, e cila i përket subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, si dhe arrin në përfundimin se depozita në shumën 35.000 USD, e krijuar në bankë në vitin 2003 në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, i përket subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të.

B.4. Për analizën e plotë financiare për vitet 2003-2016

- 30.** Komisioni në përfundim, nga analiza financiare e rishikuar për periudhën 2003 -2016, pasi analizoi shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe dokumentacionin e administruar, i rezultoi se *subjekti dhe personi i lidhur me të kanë mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën - 2.271.477 lekë.*
- 31.** Subjekti i rivlerësimit kundërshton këtë konkluzion të Komisionit, duke pretenduar se *analiza financiare e kryer nga eksperti financiar për subjektin e rivlerësimit, për periudhën në fjalë, jo vetëm që nuk rezultoi me mungesë të burimeve të ligjshme financiare, por, përkundrazi, është me tepriçë [...], në shumën +2.875.493 lekë; në kërkesat paraprake i ka kërkuar Komisionit të paraqesë analizën financiare hartuar nga ekspert i licencuar, sipas të cilit subjekti nuk rezultoi me mungesë burimesh të ligjshme në shumën 3.986.945 lekë, por me tepriçë në shumën 2.875.493 lekë; për këtë çështje, gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar, që nëse akt-ekspertimi financiar i bërë nga subjekti nuk është bindës, të përsëritet akt-ekspertimi ekonomiko-financiar me një grup prej tre ekspertësh, të licencuar, pasi vetëm kështu mund të konkludohet cila është analiza e saktë; për sa kohë që Komisioni pranoi të paraqesë dhe të marrë si provë akt-ekspertimin ose duhet të krijonte bindje në vërtetësinë dhe besueshmërinë e akt-ekspertimit, përndryshe, patjetër duhet të caktonte një grup ekspertësh më të kualifikuar, që të konkludonin më me objektivitet.*

31.1. Sipas subjektit, analiza financiare e kryer nga Komisioni ka pasaktësi të dukshme, në shumë elementë, të sqaruara prej tij në mënyrë koncize në analizën financiare depozituar në Komision, konkretisht:

- në mos konsiderimin e të ardhurave të realizuara nga bashkëshortja në shumën 270.000 lekë, për vitin 2005;
- shpenzimet e udhëtimit për periudhën 2010-2016, duhet të jenë pjesë e shpenzimeve të deklaruara nga subjekti në deklaratat e interesave privatë dhe të mos përlllogariten dy herë, duke rënduar në mënyrë të padrejtë dhe të pasaktë shpenzimet, me pasojë rezultatin me balancë negative;
- duhet korrigjuar vlera e blerjes së apartamentit në bashkëpronësi në vitin 2011, pasi Komisioni e ka konsideruar atë në vlerën 4.862.750 lekë. Sipas deklaratës vjetore, vlera e

shpenzuar për këtë apartament ishte rreth 3.500.000 lekë plus 800.000 lekë, shpenzimet e riparimeve dhe blerjet e pajisjeve për këtë apartament; në analizën financiare të kryer nga eksperti, vlera e këtij apartamenti është thujse sa deklaruar në deklaratë e interesave privatë 2011;

- *në kundërshtim me provat dhe deklaratimet, Komisioni i ka shpërndarë shpenzimet e shkollimit 1.501.649 lekë për vitin 2013 dhe 1.512.660 lekë për vitin 2014. Rezultatet e analizës financiare për vitin 2013, me tepricë pozitive në vlerën +708.833 lekë dhe për vitin 2014, me balancë negative prej - 765.490 lekësh, janë ndryshe, pasi Komisioni nuk ka marrë në konsideratë në mënyrën e duhur shpenzimet e shkollimit të djalit në Angli, të bëra me prapësimet dhe analizën e ekspertit;*
- *shpenzimet e legalizimit janë paraqitur në analizën financiare të Komisionit veçmas duke ia llogaritur dy herë këtë shpenzim;*
- *sa i takon përllogaritjes së zërit “likuiditete”, në analizën financiare të kryer nga njësia ligjore, sipas subjektit në ankim edhe pse i ka kërkuar informacion Komisionit me shkresë për llogaritjen e të dhënave përfshirë në këtë zë të analizës, subjekti nuk ka marrë asnjë të dhënë, duke mbetur i paqartë. Vlerat e këtij zëri në analizën e kryer nga Komisioni, për periudhën 2003-2016, janë të ndryshme nga përllogaritja e kryer në analizën e paraqitur në akt-ekspertim. Subjekti ngre pretendimin se nuk mund të vlerësojë dhe të japë opinion, për sa kohë që nuk ka të dhëna të detajuara për përllogaritjen e tyre nga Komisioni. Nisur nga ky fakt, subjekti i rivlerësimit i qëndron llogaritjeve të kryera nga eksperti;*
- *subjekti kërkon korrektimin e shpenzimeve të përllogaritura nga Komisioni në vitin 2013, pasi vlera e të gjitha shpenzimeve të kryera nga subjekti dhe anëtarët e familjes për vitin 2013 kanë qenë në shumën 1.600.000 lekë, si deklaruar prej tij, në deklaratë e interesave privatë të këtij viti, ndërkohë që në analizën e Komisionit janë paraqitur veç shpenzimet e udhëtimit, duke ia shtuar shumës totale të shpenzimeve deklaruar nga subjekti. Subjekti i rivlerësimit e vlerëson këtë përllogaritje arbitrare dhe tendencioze, duke bërë që bilanci i vitit 2013 të rëndohet padrejtësisht me shpenzime udhëtimi në shumën prej 172.458 lekësh, megjithëse të përfshira këto shpenzime në vlerën e shpenzimeve totale 1.600.000 lekë, deklaruar nga ana e subjektit në deklaratën e interesave privatë të këtij viti; subjekti pretendon që për efekt analize financiare është normale që shpenzimet e ushqimit të llogariten sipas INSTAT-it;*
- *për konkluzionin e Komisionit se depozita e shpenzuar është vlera e depozitës prej 35.000 USD, e cila nga hetimi rezultoi si pasuri e subjektit të rivlerësimit, ndërsa subjekti insiston se ka shpjeguar dhe vërtetuar me prova shkresore, akte noteriale, se ajo ishte pasuri monetare e mbesës M. V. dhe ish-bashkëshortit të saj, të cilëve u është kthyer, subjekti nuk e gjen me vend t’i thërrasë ata si dëshmitarë, veçse nëse dyshohet për falsifikim, pasi vërtetësia e akteve shkresore nuk provohet me dëshmitarë. Ka praktika të Kolegjit, ku është refuzuar marrja si provë e re, thirrja e një dëshmitari, i cili kërkohej nga subjekti për të vërtetuar elementët [kushtet] e një akti noterial.*

31.2. Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit, për marrjen në konsideratë të akt-ekspertimit të depozituar prej tij në Komision, si dhe informacionin e kërkuar prej tij për përllogaritjen e zërit “likuiditete” në analizën financiare të kryer nga Njësia Ligjore në Komision, të ndryshme nga përllogaritja e kryer në analizën e paraqitur në akt-ekspertim, trupi gjykues çmon se fakti që Komisioni, nuk ka konkluduar në të njëjtin rezultat financiar me atë në akt-ekspertimin e subjektit të rivlerësimit, nuk tregon se akti i ekspertimit nuk është shqyrtuar dhe analizuar nga Komisioni, pasi Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme në vlerën 3.986.945 lekë, për periudhën 2003-2016, në përfundim, pasi analizoi prapësimet e subjektit të rivlerësimit, Komisioni rishikoi analizën financiare me konsideratë shpjegimet e subjektit, duke dalë në

përfundimin se subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në vlerën - 2.271.477 lekë. Sa i takon kërkesës së subjektit drejtuar Komisionit, për kryerjen e analizës nga ekspertë të tjerë, Kolegji çmos se neni 23 i ligjit nr. 86/2016 ka përcaktuar qartë detyrat e Njësisë së Shërbimit Ligjor, si njësi ndihmëse dhe e specializuar në kryerjen e analizës financiare.

31.3. Sa i përket mos konsiderimit të të ardhurave të realizuara nga bashkëshortja në shumën 270.000 lekë, si e punësuar me kohë të pjesshme pranë subjektit “{***}” ShPK, për vitin 2005, në analizën financiare të kryer në Komision, të cilën subjekti e konsideron si pasaktësi, trupi gjykues vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit në vendimin e ankimuar, në kushtet kur nuk u provua si nga shoqëria, ashtu edhe nga subjekti i rivlerësimit pagesa e tatimit në burim, në kuptim të nenit D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës, kjo e ardhur nuk u vlerësua e ligjshme.

31.4. Trupi gjykues, në përfundim të analizimit të kujdesshëm të shpjegimeve dhënë prej tij në deklaratat e interesave privatë 2010-2016 për shpenzimet, vlerësoi të përfshijë si zë më vete në analizën financiare *shpenzimet e udhëtimit për periudhën 2010-2016*, pasi subjekti nuk i ka deklaruar ato në *shpenzimet e familjes në tërësi* si pretendon, por ka deklaruar specifikisht *shpenzime ushqimi, shkollat* në rubrikën “*Shpenzime të deklaruara*”.

31.5. Sa i takon pretendimit të subjektit *se duhet korrigjuar vlera e blerjes së apartamentit në bashkëpronësi në vitin 2011, pasi Komisioni e ka konsideruar atë në vlerën 4.862.750 lekë*, trupi gjykues ka konsideruar në analizën financiare të kryer vlerën e blerjes së apartamentit në Sarandë, 30.000 euro, sipas dokumentacionit justifikues, kontratë sipërmarrje nr. {***}rep., nr. {***} kol., datë 12.08.2011 dhe jo sipas deklaramit të subjektit në deklaratë e interesave privatë, pasi nuk specifikohet në këtë kontratë pagesa e detyrimit të z. S. T. në shumën 5.000 euro likuiduar sipërmarrësit nga subjekti i rivlerësimit.

31.6. Për pretendimin se *në kundërshtim me provat dhe deklaramit, Komisioni i ka shpërndarë shpenzimet e shkollimit 1.501.649 lekë për vitin 2013 dhe 1.512.660 lekë për vitin 2014*, trupi gjykues ka vlerësuar që në analizën financiare të kryer në Kolegji, të konsiderohet vlera e blerjes së apartamentit në Sarandë, 30.000 euro, sipas dokumentacionit justifikues, *kontratë sipërmarrje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.08.2011* dhe jo sipas deklaramit të subjektit në deklaratë e interesave privatë, pasi nuk specifikohet në këtë kontratë pagesa e detyrimit të z. S. T. në shumën 5.000 euro likuiduar sipërmarrësit nga subjekti i rivlerësimit.

31.7. Lidhur me sa pretendon subjekti se *Komisioni i ka shpërndarë shpenzimet e shkollimit të birit, K. P. në kundërshtim me provat dhe deklaramit, Komisioni i ka shpërndarë shpenzimet e shkollimit 1.501.649 lekë për vitin 2013 dhe 1.512.660 lekë për vitin 2014, [...]*, trupi gjykues nisur nga sa vetë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për vitin 2013 ka paguar [2000+2000+4.800] GBP apo 10.710 EUR, ndërsa diferencën prej 4.900 GBP apo 6.000 euro e ka likuiduar S. N. më datë 13.12.2013²², *për të plotësuar detyrimin e tarifës së shkollimit prej 11.700 GBP, me porosinë e subjektit, për lehtësi komunikimi [...], [2.400+4.900] GBP x 179.48 ALL/GBP+1.800 euro x 140.11 ALL/EUR*, çmon se *pretendimi i mësipërm i subjektit nuk qëndron, pasi shpërndarja e shpenzimeve për shkollim është bërë në përputhje me dokumentacionin justifikues të administruar për këtë çështje*.

31.8. Pretendimin e subjektit se *shpenzimet e legalizimit janë paraqitur në analizën financiare të Komisionit veçmas duke ia llogaritur dy herë këtë shpenzim*, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe e ka reflektuar në analizën financiare të kryer.

²² Sipas deklaramit të subjektit të rivlerësimit në përgjigje të pyetjes nr. 1, të Pyetësorit nr. 3, të Komisionit.

31.9. *Për korrektimin e shpenzimeve të përllogaritura nga Komisioni në vitin 2013* kërkuar nga subjekti, pasi vlera e të gjitha shpenzimeve të kryera nga subjekti dhe anëtarët e familjes për vitin 2013, kanë qenë në shumën 1.600.000 lekë si deklaruar prej tij, trupi gjykues, pasi shqyrtoi deklarin e subjektit në deklaratë e interesave privatë 2013, rubrika “Shpenzime të deklarueshme”, konstaton që subjekti të ketë deklaruar shpenzime ushqimi, shkollat, shpenzimet e familjes për vitin 2013 = 1.600.000 lekë [pa llogaritur arsimin e K. në Angli]. Kursimi gjatë vitit nga të dy pagat është 1.188.068 lekë, zbrësim shpenzimet e ushqimit e shkollat 1.600.000 lekë , [...], pra, nuk ka përfshirë shpenzimet e udhëtimit dhe ato të shkollimit të të birit në këtë vlerë. Në këto kushte, shpenzime jetike në Kolegj u përllogariten sipas deklarin të subjektit në deklaratën e interesave privatë 2013.

31.10. *Për qëndrimin e subjekti të rivlerësimit kundër konkluzionit të Komisionit se depozita e shpenzuar është vlera e depozitës prej 35.000 USD, e cila nga hetimi rezultoi si pasuri e subjektit të rivlerësimit*, ndërsa insiston se ka shpjeguar dhe vërtetuar me prova shkresore, akte noteriale, se ajo ishte pasuri monetare e mbesës M. V. dhe ish-bashkëshortit të saj, të cilëve u është kthyer, [...], trupi gjykues në Kolegj, si arsyetuar më lart në këtë vendim,(paragrafi 29.3), në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk depozitoi dokument justifikues për të provuar dhënien apo transferimin e shumave nga M. V. që kanë krijuar depozitën 35.000 USD, çmon të llogarisë këtë depozitë në analizën financiare të kryer në Kolegj për subjektin e rivlerësimit dhe personin e lidhur.

- 32.** Lidhur me analizën ekonomike-financiare të kryer për periudhën e rivlerësimit, 2003-2016, trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi shkaqet dhe kërkimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, shqyrtoi provat dhe aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, konfirmoi balancën negative të rezultuar nga analiza financiare e kryer për të njëjtën periudhë në Komision, duke konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, kursimet dhe shpenzimet e kryera në këto vite, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
- 33.** Në arsyetim të sa sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë të konsiderueshme të burimeve financiare të ligjshme në vlerën - 2.546.716 lekë për të justifikuar shpenzimet e kryera ndër vite, në raport me të ardhurat e ligjshme të deklaruara, të verifikuara e të provuara gjatë procesit të rivlerësimit. Trupi gjykues në përfundim, në zbatim të parimit të mospërkeqësimit të pozitës së subjektit, konfirmon mungesën e burimeve financiare të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur, që ka rezultuar në Komision në vlerën - 2.271.477 lekë. Sikurse u trajtua gjerësisht edhe më sipër, edhe nëse abstragohet nga fakti që pretendimet për pasaktësitë në deklaratat e interesave privatë vjetorë nuk ishin bindëse, argumentet e subjektit nuk mund të përmbysin konstatimin që subjekti ndodhet në kushtet e deklarin të pamjaftueshëm, për shkak të mungesës së burimeve të ligjshme për të mbuluar shpenzimet e deklaruara ndër vite. Për rrjedhojë, subjekti nuk arrin nivel të besueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë.
- 34.** Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, për kriterin e vlerësimit të pasurisë gjendet në kushtet e parashikuara nga neni D, pikat 1,3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, vendimi nr. 196, datë 13.09.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, është i mbështetur në ligj e në prova dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 196, datë 13.09.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Gjovalin Përnoca.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 25.07.2022.

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi